

Buxheti
Kalendari i
Gjergjit varet
nga fondi

Fq.4



**BLERJA E
MERCEDESIT**
"Tanku"
anulohet ende
pa filluar

Fq.5



**Gatuso më
meritori
për
ringritjen
e Milanit**

Fq.22



Koha

www.koha.mk



**Rusia pa
Putinin**

Fq.13

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3280 · e mërkurë 31 janar, 2018

-3°C | 9°C

15 DEN

EDITORIAL

**Kurthet
e një harbuti**



Branko Manoilovski kishte dy rrugë në përballjen me Vasko Eftovin, ose ta injoronte fare, me mos shkuarje në debat, ose të shfaqej me përgjigje më dinamike, më përmbajtësore dhe, mbi të gjitha, më argumentuese. Nuk u kuptua gjithë ajo mirësjellje e Brankos me një sharlatan që gabimisht i ka vjedhë veglat e gazetarisë dhe pa fije turpi bën "obduksione" mbi fatet e njerëzve. A kishte nevojë plaku i Kiçinicës të tregojë aq skandinav edhe pas akuzave se ai gjoja në këmbim të parave e paska ndërruar identitetin dhe joshjet e ndryshme e paskan bërë atë...

Fq.2

GLOBI

**Policia në
kërkim të
hajdutëve që
vodhën 44 ton
çokollatë**

Fq.13

RAJON

**Mos i hapni
as dritaret
për ajrosje**

Fq.12



PËRKTHEHEN 35 MIJË AMENDAMENTET E VMRO-SË

ÇELËSI TE XHAFERI!



Në Parlament janë shpeshtuar zërat se mundësia është e madhe që 35 mijë amendamentet e VMRO-së të njësohen në një apo disa dhe kjo çështje të merr fund me votimin e Ligjit. "Nëse për të njëjtën dispozitë janë paraqitur dy apo më shumë amendamente me përmbajtje të ngjashme, me propozim të Kryetarit, trupi punues mund të vendosë që për amendamentet të mbahet diskutim i përbashkët, ndërsa për çdo amendament të votohet ndaras", thuhet në pargarfin 4 të nenit 153 të Rregullores për punë të Parlamentit

Fq.3

Maqedonisht mësojnë edhe shqiptarët dhe turqit

Shkup, 30 janar - Politika e dominimit të shumicës në sistemin arsimor në Maqedoni, sigurisht që nuk janë të ditëve të sotme. Por problemi qëndron në mos ndryshimin e gjendjes dhe mos marrjen e masave për parandalimin e pabarazive në sistemin arsimor. Për pasojë, tani e shumë vite kemi dallimin relativisht të madh të mundësive që ofrohen për shkollim të mesme, varësisht gjuhës së mësim, krahasuar me

numrin e nxënësve që përfundojnë arsimin filior në të njëjtën gjuhë. Deri në vitin 2006, kur në Maqedoni nuk ishte i detyrueshëm arsimi i mesëm, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) ofronte për nxënësit maqedonas 10-15 për qind më tepër vende se sa ishte realisht për qindja e atyre që mbaronin shkollën fillore në gjuhën maqedonase. E kundërta ndodhte për shqiptarët. MASH ofronte...

Fq.4



EDITORIAL

KURTHET
E NJË HARBUTI

Emin AZEMI

Branko Manoilovski kishte dy rrugë në përballjen me Vasko Eftovin, ose ta injoronte fare, me mos shkuarje në debat, ose të shfaqej me përgjigje më dinamike, më përmbajtësore dhe, mbi të gjitha, më argumentuese. Nuk u kuptua gjithë ajo mirësjellje e Brankos me një sharlatan që gabimisht i ka vjedhë veglat e gazetarisë dhe pa fije turpi bën "obduksione" mbi fatet e njerëzve. A kishte nevojë plaku i Kicinics të tregojë aq skandinav edhe pas akuzave se ai gjoja në këmbim të parave e paska ndërruar identitetin dhe joshjet e ndryshme e paskan bërë atë shqiptar. Ai përballë kishte një idiot që kot hiqet si gazetar, sepse gazetarinë e përdor vetëm sa për t'i bërë punët llugë, kurse të ftuarit, për gjoja debat, i shënjestron si cak goditjesh e komprometimesh.



Janë të njohur tipat si ky Eftovi, madje ai tani mundohet të tregohet një nxënës i dobët i pararendësve të tij në disa media të Beogradit, të cilët nën gunën e gazetarit fshihnin hanxharët e udbashëve, sepse vetëm në atë mënyrë mund t'u afroreshin njerëzve dhe të maskuar me identitete të rrejshme, në fakt, kryenin punët e pista të shefave të tyre nëpër shërbimet sekrete.

Edhe ky hamami i Shkupit, që as vet s'e din çfarë mahlukati është, u mundua ta çorientojë gjatë debatit Manoilovskin, duke e detyruar të shkretin të thotë disa herë "da, potpuno ste vo pravo"(!), por pa përgjigje të shumta në provokimet që kërkonin më shumë shpjegime e më pak buzëqeshje.

Historia e dhimbshme e asimilimeve kombëtare e fetare të shqiptarëve, nuk kishte mundësi të përbirohej në një grykë aq të ngushtë kohe sa ishte krejt hapësira programore e debatit, ku më tepër u fol për teknikalitetet e një identiteti, se sa për çështje cruciale, për të cilat, u pa se Brankoja nuk ishte i gjitha i përgatitur. Pas një mori deklarimesh publike për shqiptarësinë e tij, Brankoja nuk e kishte për detyrë ta ridëshmonte të njëjtën para një harbuti plangprishur. Ai duhej të fliste për një realitet të dhimbshëm edentitar, i cili ishte deformuar e keqtrajtuar në periudha të ndryshme kohore dhe asnjëherë në të kaluarën, komuniteti ortodoks shqiptar, pas Josif Bagerit, nuk e pati një zë artikullues që do të shprehte kapacitetet përfaqësuese të tij. Mirë u bë që tash së fundi, u paraqitën zëra të tillë (duhej patjetër ta përmendte rastin e Mateja Matevskit) dhe mirë u bë që këta zëra patën edhe mbështetje politike, por ortodoksia shqiptare në Maqedoni meriton një trajtim më serioz, madje edhe nga përfaqësuesit e saj nëpër studio televizive.

Falsifikuesit sllavë të historisë së shqiptarëve kanë treguar zell të pakursyer për t'i paraqitur të gjithë shqiptarët e Maqedonisë si myslimanë, argument ky, që sipas tyre e redukton edhe kohëzgjatjen e autoktonisë shqiptare në këto troje. Nëse shqiptarët e këtushëm janë vetëm myslimanë, atëherë ky argument, sipas tyre, është shumë i kollajshëm për të dëshmuar se gjoja ata (shqiptarët) kanë ardhur këtu bashkë me religjionin e tyre - mysliman, menjëherë pas invadimit Otoman në Ballkan. Po del se, çdo ushtar osmanli nën sjetull paska sjellë me vete nga 2-3 shqiptarë dhe i kanë hedhur si farat e hithit nëpër shkurret e mallet e këtushme. Prandaj, autoktonia shqiptare në Maqedoni, gabimisht dhe djallëzisht është trajtuar nga studiuesit sllavë, si dhe nga qendrat politike në Moskë, Beograd e Shkup vetëm si segment nacional i shqiptarëve myslimanë, pa dhënë asnjëherë sqarime se çka ndodhi me vazhdimësinë territoriale e etnike të ortodoksëve shqiptarë në Maqedoni. S'do mend se edhe Vasko Eftov pretendon idiotçe se të jesh shqiptar në Maqedoni, duhesh patjetër të jesh mysliman dhe sipas tij, ortodoksia është e rezervuar vetëm për sllavët dhe fqinjët e tyre grekë, bullgarë, rumunë etj.

Nëse ortodoksia shqiptare, si grafikon i mohuar deri më tani, nxjerr nga skema e vjetër një komunitet të tërë, atëherë sponsorët e Eftovit nuk e kanë hallin te Brankoja i Rekës së Epërme, por te lumenjtë e dikurshëm të fryrjeve false demografike, të cilat nesër mund të shndërrohen në përroska.



BUXHETI PËR FILMA - IRRITUES!

"Kur SDSM edhe përkrahësit e saj të shumtë o (e ndër ta edhe shqiptarë) flasin për 'jetë për të gjithë' a thua vallë për çfarë jete mendojnë? A mendojnë jetë për të gjithë, por pak më pak për ne shqiptarët? A duhet të ndjehemi rahat se s'po na e mohojnë të drejtën për jetë, duke e pranuar faktin se jeta e tyre është pak më e vlefshme se e jona, por së paku edhe ne kemi të drejtë të jetojmë. A duhet edhe ne të dakordohemi me ta se barabarësia e plotë në çdo fushë është një gjë e tepërt për të kërkuar? Më irritoi shumë vendimi për ndarjen e mjeteve nga Fondi për Film i Maqedonisë, ku përsëri dy filma maqedonas marrin jashtë mase shumë para dhe asnjë film shqiptar. Pesë filma të huaj kanë fituar buxhet për bashkëpunim, ndër të cilët dy filma shqiptar, një nga Kosova dhe një nga Shqipëria dhe tre tjerët janë filma sllav. E habitshmja është se dy filmat shqiptar kanë buxhet më të ulët krahasimisht me ato sllavët, sepse ka jetë për të gjithë, por ama për ne pak më pak. Buxheti për film dokumentar i shkon një producenti shqiptar. Por ama është më i vogël se buxheti për film dokumentar i një krijuesi debutant maqedonas, sepse jeta është për të gjithë, por për ata pak më shumë. I irrituar u them juve të SDSM-DPMNE (bashkë me trupin tuaj votues/përkrahës shqiptarë) se ja keni filluar shumë keq, edhe po vazhduat kështu edhe do të përfundoni keq", ka shkruar aktori Luran Ahmeti në profilin e tij në Facebook.

NGA GJILANI NË OXFORD

"Kur ndonjë nxënës në Britani të Madhe pranohet për të studiuar në universitetin e Oxford-it dhe Cambridge-it, është lajm i rëndësishëm. Për të shkruajnë së paku gazetën rajonale. Kësaj radhe ka ndodhe që vetëm nga një shkollë që gjendet në lindje të Londrës të pranohen në Oxford dhe Cambridge 22 nxënës. Në mesin e këtyre nxënësve të shkëlqyeshëm apo të jashtzakonshëm, të cilën e ka veçuar media britanike, është Mirana Kqiku nga Gjilani, e cila është pranuar në Oxford. Ky është një lajm shumë i mirë për ata që dinë se çka është Oxford-i dhe Cambridge-i. Kjo është arsyeja që ky lajm sot i ka vërshuar mediat britanike", shkruan publicisti nga Londra, Daut Dauti.

TË TREGOJMË LIDERSHIP TË DUHUR

"Pak ditë kanë mbetur deri te publikimi i Strategjisë së Zgjerimit të Komisionit Evropian për integrimin evropian të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kjo është një mundësi historike që edhe Kosova të përfshihet denjësisht në këtë strategji dhe qytetarët e Kosovës të kenë qartësi për hapat e radhës drejt integritimit në Bashkimin Evropian. Kjo qartësi, së bashku me lëvizjen e lirë dhe pa viza, do të ishin lajmi më i mirë për çdo qytetar të Kosovës në dhjetëvjetorin e pavarësisë së shtetit tonë. Bashkimi Evropian, i cili ka në dorë këtë strategji dhe vendimet e tjera të rëndësishme për vendin tonë, nuk preokupohet se çfarë dëshiron qytetari, por është i interesuar të shoh sa i kanë përmbushur kërkesat e tyre institucionet e vendit tonë. Prandaj, këtu nuk ka të panjohura. Tani nuk është koha për fajësime apo shfajësime, por për veprime në interes të shtetit dhe qytetarëve", shkruan presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në profilin zyrtar të tij në Facebook.

MEDIACitate

"Rusia e ka shfrytëzuar gjithmonë Serbinë si trampolinë për realizimin e interesave të saj gjeopolitike. Serbinë, më shumë shtet e ka bërë Evropa sesa Rusia. Se sa e mbrojti Rusia këtë shtet u pa në vitin 1999, gjatë bombardimeve të NATO-s, kur asnjë ushtar rus nuk vdiq për Serbinë. Evropa ka kontribuar më shumë për Serbinë: Po të mos ishin investimet evropiane, ky shtet do të kishte falimentuar prej vitesh. Vetëm në 10 vitet e fundit, BE ka investuar mbi 5 miliardë euro. Evropa hap çdo ditë fabrika të reja, duke punësuar serbë të shumtë. Politologu Cvetičanin thekson se Putin, në një bisedë me partnerët e tij perëndimorë, ka thënë se "unë nuk jam miku juaj, por as armiku juaj. Unë jam President i Rusisë".

(Blic, 30 janar)

Zëvendëskryeministria e Serbisë, njëherësh ministre e Ndërtimitarisë, Transportit dhe Infrastrukturës, Zorana Mihajloviq, ka thënë se është shumë e rëndësishme që Serbia të lidhë rrugët me vendet e rajonit dhe ka shtuar se autostrada Nish-Merdar-Prishtinë, është e rëndësishme për të gjithë rajonin por edhe për Serbinë. "Është gjithashtu e rëndësishme për popullin tonë që jeton në Kosovë dhe për Serbinë që të dalë në porte, si dhe për kompanitë tona të ndërtimit", tha ajo gjatë Konferencës Rajonale për Barazinë Gjinore dhe Reformën e Administratës Publike në Ballkanin Perëndimor.

(Klan Kosova, 30 janar)

Mijëra njerëz kanë dalë në rrugë në kryeqytetin shqiptar Tiranë në protestë kundër qeverisë socialiste të Edi Ramës. Demonstruesit akuzuan kryeministrin dhe ministrat e tij për korrupsion dhe lidhje me krimin e organizuar. Ata kanë kërkuar dorëheqjen e Ramës, i cili është konfirmuar në detyrë në zgjedhjet e qershorit. Tubimi u organizua nga partitë e opozitës. Ata akuzojnë qeverinë e Ramës se ka bërë marrëveshje fitimprurëse me trafikantët shqiptarë të kanabisit. 'Rama e ka bërë Shqipërinë shtëpinë e krimit të organizuar dhe drogës,' - tha udhëheqësi i Partisë Demokratike, Lulzim Basha në fjalën e tij për pjesëmarrësit.

(Televizioni gjerman ARD, 30 janar)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

ÇFARË DIHET PËR BETEJËN E KOSOVËS?

Beteja e Kosovës u zhvillua më 15 qershor 1389 në Fushën e Kosovës, në afërsi të Prishtinës midis ushtrive të një koalicioni antiosman të kryesuar nga princi serb Lazar dhe ushtrisë osmane të komanduar nga Sulltan Murati I. Osmanët kishin vazhduar pushtimet e tyre duke arritur deri në trevat shqiptare dhe serbe. Për sundimtarët e Evropës juglindore po bëhej e qartë se vërshimi osman nuk mund

të përballohej me forcat e tyre të veçuara. Të ndodhur përballë një armiku të përbashkët, princërit, mbretërit e fisnikët shqiptarë, serbë, bullgarë e rumunë i fashitën mosmarrëveshjet duke krijuar një koalicion antiosman. Beteja u zhvillua ndërmjet 100.000 ushtarëve osmanë dhe 40.000 luftëtarëve ballkanas. Beteja përfundoi me fitoren e osmanëve.

PO PËRKTHEHEN 35 MIJË AMENDAMENTET E VMRO-SË

ÇELËSI TE XHAFERI!

Në Parlament janë shpeshuar zërat se mundësia është e madhe që 35 mijë amendamentet e VMRO-së të njësohen në një apo disa dhe kjo çështje të merr fund me votimin e Ligjit. "Nëse për të njëjtën dispozitë janë paraqitur dy apo më shumë amendamente me përmbajtje të ngjashme, me propozim të Kryetarit, trupi punues mund të vendosë që për amendamentet të mbahet diskutim i përbashkët, ndërsa për çdo amendament të votohet ndaras", thuhet në pargarfin 4 të nenit 153 të Rregullores për punë të Parlamentit



kanë rreth 300 amendamente, siç qëndron rasti me nenin 5, kjo do të merr kohë. Duket qartë se kjo është çështje politike, dhe amendamentet janë sjellë që të bllokohet Ligji. Çdo pranim i mundshëm i një amendamenti do të paraqesë kërcënim të Kushtetutës. Në procedurë parlamentare, Ligji është harmonizuar me Kushtetutën dhe nuk ka baza që i njëjti të cilësohet si antikushtetues", tha Xhaferi. Ndryshe, në Parlament janë shpeshuar zërat se mundësia është e madhe që të 35 mijë amendamentet të njësohen në një apo disa dhe kjo çështje të merr fund me votimin e Ligjit për gjuhët pa u ndryshuar përmbajtja e tij. Por nga BDI nuk pranojnë të flasin diçka rreth kësaj teme, kurse nga LSDM - deputet të saj thonë se pasi të kenë në duar materialet, do të shikojnë mundësitë që jep Rregullorja e punës rreth shqyrtimit sa më të shpejtë të amendamenteve. Ndërkohë, në opinion janë ngritur dilema se vetë fakti që VMRO mbi 90 për qind të amendamenteve i ka propozuar për uljen e dënimeve, jep të kuptoj se paraprakisht ajo e ka ditur se me propozim të kryetarit të Parlamentit, deputetët do të vendosin për akumulimin e amendamenteve sepse këtë ia mundëson Rregullorja dhe praktika parlamentare. Por VMRO, sipas këtyre zërave, meqë ka ngritur kauzë kundër këtij Ligji, do t'i duhet të bëj zhurmë sado pak kjo për t'u arsyetuar para anëtarësisë dhe simpatizantëve të vet duke e ditur që binomi LSMD-BDI nuk do ta ndryshojë Ligjin për gjuhët.

Ndërkaq, vetë njëri nga kryetarët e dhjetë grupeve parlamentare të VMRO-së, Ilija Dimovski, gjatë një brifingu me gazetarë tha se partia e tij nuk ka për qëllim që ta pen-

gojë debatin që ka të bëjë me Ligjin e gjuhëve. Ai thekson se ky ende nuk është Ligj, por është propozim-ligj pasi që nuk është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë. "Dorëzimi i 35 mijë amendamenteve është me qëllim që të zgjohet vetëdija te Qeveria se për këtë çështje duhet që të arrihet konsensus. Ato duhet të bisedojnë me profesorë, juristë dhe albanologë, ti dëgjojnë qëndrimet e tyre dhe po ashtu të konsultohen edhe partitë më të vogla politike. VMRO po të donte ta bllokonte punën e Parlamentit, do të dorëzonte 350 mijë amendamente, e jo vetëm 35 mijë", tha Dimovski nga VMRO. Në ndërkohë, deputetët e LSDM-së thonë se pasi të shohin materialet - do të dalin me qëndrime. Sipas tyre, do të shfrytëzohet çdo mundësi që jep Rregullorja e punës që ky Ligj të kalohet me sukses. "Së pari ti shohim materialet. Talat Xhaferi tha se shumica janë për dënimet, por ne duhet ti shohim dhe më pas të dalim me qëndrime. Sigurisht se të shikohet çdo mundësi që jep Rregullorja e punës rreth amendamenteve me qëllim që ky Ligj të kalohet me sukses dhe pa ndryshime", thonë deputetët e LSDM-së. Nga BDI përjashtojnë çfarëdo kompromisi me VMRO-në për pranimin e ndonjë amendamenti që ka të bëjë me uljen e dënimeve. "S'do të ketë kompromis me VMRO-në për ndonjë amenda-

Neni 153 (4):

Nëse për të njëjtën dispozitë janë paraqitur dy apo më shumë amendamente me përmbajtje të ngjashme, me propozim të Kryetarit, trupi punues mund të vendosë që për amendamentet të mbahet diskutim i përbashkët, ndërsa për çdo amendament të votohet ndaras

jokompatibilitet dhe moskuptim të së sotmes dhe pritjeve të qytetarëve. Shteti është para sfidave të mëdha historike dhe ka nevojë për opozitë të përgjegjshme", theksoi Grubi. Kur jemi tek Ligji për gjuhët në lexim të tretë, sipas Rregullores së punës - mund të propozohen amendamente, në këtë rast siç ka bërë VMRO, vetëm në kuadër të vërejtjeve të Presidentit. Për çdo amendament propozuesi i tij ka të drejtën e arsyetimit në tre minuta ndërsa nëse është kryetari i grupit parlamentar, mund të flasë deri në dhjetë minuta. Ndërkaq neni 153 i Rregullores së punës në paragrafin 4 jep mundësinë që për një nen - nëse ka dy apo më shumë amendamente me përmbajtje të ngjashme, me propozim të kryetarit të Parlamentit, trupi punues mund të vendosë që të mbahet një diskutimi i përbashkët.



Koha për vendime

Athinë, 30 janar - Ekziston momenti, koha ka ardhur për marrje të vendimeve, porositi ndërmjetësuasi Methju Nimic takimit me ministrin e Punëve të Jashtme të Greqisë në MPJ-në greke. Me Nikos Koxiasin, kanë biseduar për idetë të cilat ndërmjetësuasi i dorëzoi para dy javësh, i ka dëgjuar pozicionet e qeverisë dhe thotë se ekziston vullnet edhe tek të dyja palët për arritje të marrëveshjes. Duke e vlerësuar takimin si konstruktiv, Nimic tha se Qeveria greke është e sinqertë dhe aktive në zgjidhjen e problemit. "Mendoj se ka ardhur momenti. Pritja nuk ka kuptim as këtu, e as tek fqinji verior, përgjithësisht nuk ka kuptim. Bisedojmë për këtë çështje 25 vite, të gjithë e dinë se cilat janë çështjet. Ka ardhur koha për marrje të vendimeve dhe mendoj se jemi në këtë pikë", tha ndërmjetësuasi pas takimit me Koxiasin, pa dhënë afat konkret kohor, duke potencuar se javëve të ardhshme do të ketë bisedime dhe pastaj do të duhet prej në fillim të vlerësohet situata. Përfaqësuesi i posaçëm i KB-së në bisedimet për emrin, njofton korrespondenti i MIA-s nga Athina, në deklaratë për mediat, nuk dëshiroi t'i zbulojë idetë dhe propozimet e tij, duke thënë se nuk është ide e mirë të komentojë se çka ka propozuar. Theksoi se në mediat dolën disa nga idetë, por theksoi se publikisht tani për tani nuk mund të flitet për këtë. "Të dy qeveritë mund të mendojnë edhe ide të tyre ose shpresoj të shfrytëzojnë disa nga idetë e mia. Asnjëherë nuk jap ide përfundimtare, unë jam ndërmjetësues, e jo gjykatës. Nga ana ime jap ide për të cilat konsideroj se janë më të mirat për momentin", tha Nimic. Ndërmjetësuasi dhe shefi i diplomacisë greke pas takimit 40-minutësh, bisedimet i vazhduan në drekë pune. Ai paraprakisht kishte takim me Jorgos Kumucakosin përgjegjës për politikë të jashtme në partinë opozitare Demokracia e Re, por pas takimit nuk janë dhënë deklarata për mediat. Ndërmjetësuasi i KB-së nga Athina nesër vjen në Shkup në bisedime dyditore me kreun shtetëror të Maqedonisë.

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 30 janar - As në vazhdimin e dytë të seancës së 32-të me radhë Ligji për gjuhët nuk u votua si pikë e veçantë e rendit të ditës, por u kalua duke votuar pikat tjera në mesin e të cilave dhe ligjet që prekin reformat në sferën e sigurisë. Siç njoftoi kryeparlamentari Talat Xhaferi gjatë një brifingu me gazetarë, deri të martën paradite janë përkthyer vetëm 17 mijë amendamente nga 35 mijë gjithsej, ndërsa akuzoi VMRO-në se po shfrytëzon procedura parlamentare për të bllokuar Ligjin. Sa i përket mundësisë së akumulimit të amendamenteve, Xhaferi tha se nuk mund të flas asgjë përderisa nuk i kanë ende materialet në duar. "Ato amendamente janë sjellë që të mos miratohet Ligji. Ka formë procedurale, por qëllimi është politik. Kur flasim për procedurë, kishte amendamente në lexim të dytë. Këtu përdoret procedura që të bëhet politikë", tha Xhaferi. I njëjti i bëri apel VMRO-së që të punojë drejt konsensusit politik dhe që të tërheq amendamentet. "Deri në këtë moment janë përkthyer deri 17 mijë amendamente, ka nene që

Në statistikat që jepen lidhur me numrin nxënësve në shkolla, bën përshtypje raporti jo i drejtë i nxënësve sipas përkatësisë etnike krahasuar me numrin e atyre që mësojnë në atë gjuhë. Kësaj dukurie nuk i ka shpëtuar as arsimit fillor. Nëse në shkollat fillore ishin 104.254 nxënës me përkatësi etnike maqedonase, në paralelet me mësim po në gjuhën maqedonase numri i nxënësve ishte 122.929, sepse 1217 nxënës që mësonin në ato paralele ishin shqiptarë dhe 2811 turq

Koha

Laura PAPANIKU

Shkup, 30 janar - Politika e dominimit të shumicës në sistemin arsimor në Maqedoni, sigurisht që nuk janë të ditëve të sotme. Por problemi qëndron në mos ndryshimin e gjendjes dhe mos marrjen e masave për parandalimin e pabarazive në sistemin arsimor. Për pasojë, tani e shumë vite kemi dallimin relativisht të madh të mundësive që ofrohen për shkollim të mesme, varësisht gjuhës së mësim, krahasuar me numrin e nxënësve që përfundojnë arsimin fillor në të njëjtën gjuhë. Deri në vitin 2006, kur në Maqedoni nuk ishte i detyrueshëm arsimi i mesëm, Ministria e Arsimit

EDHE PSE KANË SHKOLLA NË GJUHËN E TYRE

MAQEDONISHT MËSOJNË EDHE SHQIPTARËT DHE TURQIT!



dhe Shkencës (MASH) ofronte për nxënësit maqedonas 10-15 për qind më tepër vende se sa ishte realisht për qindja e atyre që mbaronin shkollën fillore në gjuhën maqedonase. E kundërta ndodhte për shqiptarët. MASH ofronte deri 45 për qind më pak vende se sa ishte realisht numri i gjysmëmaturantëve që mbaronin shkollën fillore në gjuhën shqipe. Dallimi në larminë e drejtimeve dhe profileve ishte gjithashtu jashtëzakonisht i madh.

Fatkeqësisht, kjo qasje nuk ka ndryshuar në thelb as këto 10 vite që arsimit i mesëm është kthyer në detyrim ligjor për të gjithë dhe që me konkurset për regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme, MASH lejon mijëra vende më shumë se sa është numri i gjysmëmaturantëve të atij viti. Për qindjet

e gjysmëmaturantëve maqedonas me përqindjet e vendeve që jepen për regjistrim në paralelet me mësim në gjuhën maqedonase nuk janë asnjëherë të përafërta. Oferta që bëhet për ta në sasi dhe përqindje është çdoherë më e lartë. Pra, për to jepen çdoherë më shumë vende, për dallim prej ofertës që bëhet për nxënësit shqiptarë dhe e cila është çdoherë më e ngushtë. Ajo që ka bërë përshtypje në statistikat që jepen lidhur me numrin nxënësve në shkolla është raporti jo i drejtë i nxënësve sipas përkatësisë etnike krahasuar me numrin e atyre që mësojnë në atë gjuhë. Madje, të dhënat e para tre viteve tregonin se kësaj dukurie nuk i ka shpëtuar as arsimit fillor. Kështu, nëse në shkollat fillore ishin 104.254 nxënës

me përkatësi etnike maqedonase, në paralelet me mësim në gjuhën maqedonase numri i nxënësve ishte 122.929. Sepse, 1217 nxënës që mësonin në ato paralele ishin shqiptarë dhe 2811 turq. Ndërkaq, nëse në shkollat fillore ishin 62.188 nxënës shqiptarë sipas përkatësisë etnike, në paralelet me mësim në gjuhën shqipe ishin 61.298 nxënës edhe atë 60.787 shqiptarë dhe 81 turq. Mirëpo, nuk është i vogël as numri i nxënësve shqiptarë që mësojnë në gjuhën turke. Konkretisht, në ato paralele krahas 5630 nxënësve turq - mësonin edhe 184 nxënës shqiptarë duke e çuar në 5821 numrin e nxënësve në paralelet me mësim në gjuhën turke. Në paralelet me mësim në gjuhën serbe, përveç 438 nxënësve serb me përkatësi etnike, numëroheshin edhe 45 nxënës maqedonas sipas përkatësisë etnike. Në paralelet me mësim në gjuhën shqipe dhe turke nuk ka asnjë nxënës maqedonas apo serb. Vitin e shkuar, në nivel të Maqedonisë - numri i gjysmëmaturantëve shqiptarë ishte 33 për qind, ndërsa numri i vendeve në paralelet me mësim në gjuhën shqipe në Konkursin për regjistrim në shkollat e mesme ishte 29 për qind, pra oferta është për 4 shkallë më pak se sa do të duhej të ishte realisht. Nga ana tjetër, për maqedonasit raporti është në kahen e kundërt. Nëse

për nga numri i gjysmëmaturantëve ose atyre që kryejnë arsimin fillor në gjuhën maqedonase përqindja e tyre është në nivelin e 64, numri i vendeve në shkollat e mesme arrin në 68 për qind. Pra oferta për ta është për katër shkallë më e lartë se sa do të duhej të ishte realisht. Në këto raporte konsistente dhe situata me shkollat e mesme të kryeqytetit. Vitin e kaluar, për shembull, numri i vendeve në paralelet shqipe (3238) përbënte 33 për qind të numrit të përgjithshëm të vendeve të lira në shkollat komunale të Shkupit (9766), kurse numri i nxënësve që po atë vit kishin përfunduar arsimin fillor në gjuhën shqipe ishte 39 për qind (2112). Në qershor të vitit të kaluar, sikurse ka bërë të ditur Qyteti i Shkupit, arsimin fillor e kishin mbaruar 5416 nxënës. Prej tyre, 2112 kishin mësuar në gjuhën shqipe, 3180 në gjuhën maqedonase dhe të tjerët në gjuhën turke, serbe dhe boshnjake. Ndërkaq, për paralelet me mësim në gjuhën maqedonase ishin lejuar 67 për qind e vendeve (6410), ndërkohë që numri i atyre që kishin mbaruar filloren në gjuhën maqedonase ishte 59 për qind (3180). Në shkollat e mesme komunale të Shkupit për atë vit shkollor ishin planifikuar 9776 vende, ndërsa arsimin fillor e mbaruan 5416 gjysmëmaturantë.

ORGANIZATORËT NË PRITJE TË BUXHETIT NGA QEVERIA

Kalendari i Gjergjit varet nga fondi

Edhe pse Këshilli i ngritur nën patronazhin e kreut të Parlamentit, Talat Xhaferi, është mbledhur dy herë për të caktuar kornizat dhe përmbajtjen e organizimit, akoma nuk dihet se cilat do të jenë të gjitha aktivitetet dhe çfarë do të përfshihen në to

Koha

Evis HALILI

Shkup, 30 janar - Se si do të shënohet festimi i "Vitet të Skënderbeut" në Maqedoni dhe cilat manifestime do të organizohen me këtë rast - do të varet nga buxheti që do

të akordohet nga Qeveria dhe Ministria e Kulturës. Edhe pse Këshilli i ngritur nën patronazhin e kreut të Parlamentit, Talat Xhaferi, është mbledhur dy herë për të caktuar kornizat dhe përmbajtjen e organizimit, akoma nuk dihet se cilat do të jenë të gjitha aktivitetet dhe çfarë do të përfshihen në to. Zëvendëskryetari i Këshillit, Skënder Asani, pohon se Instituti i Trashëgimisë që është bartës i këtyre aktiviteteve e ka gati programin, i cili është dorëzuar në Qeveri. Se sa aktivitetet dhe si do të organizohen ato - do të varet nga buxheti që do të akordojë Qeveria dhe Ministria e Kulturës. Nga ana tjetër, ai shton se shënimi i "Vitet të Skënderbeut" në Maqedoni ka një projekt tepër ambicioz që nuk gjendet në agjendën e festimeve në Shqipëri apo Kosovë. Bëhet fjalë për botimin e një libri për Skënderbeun, vepër kjo e cila për herë të parë do

të sjellë të përmbledhura studime nga historianë jo vetëm shqiptarë, por edhe të huaj, si maqedonas, amerikanë, e të tjerë të cilët do të prezantojnë dëshmi dhe materiale të panjohura deri tani.

"Ne si Këshill dhe ITSHKSH e kemi hartuar kalendarin e aktiviteteve, koston e tyre dhe presim miratimin. Por për momentin nuk mund të flasim me detaje, pasi mënyra e organizimit do të varet nga buxheti që do të caktohet. Por sido që të jetë - një pjesë të mirë të aktiviteteve ne do t'i realizojmë si Institut. Mund të them lirshëm se krahasuar me Shqipërinë apo Kosovën, ne do të kemi aktivitete shumë ambicioze, siç është promovimi i librit për Skënderbeun, një botim nga autorë të huaj. Po ashtu, planifikojmë edhe organizimin e Javës së Kulturës shqiptare dhe shumë ngjarje të tjera. Në tërësi, ne kemi projektuar një vit



me aktivitete", thotë Asani. Edhe pse "Viti i Skënderbeut" u shpall si një vit i manifestimeve mbarëshqiptare, deri tani nuk ka pasur ndonjë koordinim për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta për datat madhore, si 110 vjetori i Kongresit të Manastirit, që gjendet edhe në agjendën e festimeve të qeverisë së Shqipërisë. Në Maqedoni Viti i Gjergjit nisi më 17 janar, me shënimin e përvjetorit të 550 të vdekjes së Skënderbeut dhe promovimin e pullës postare me

imazhin e heroit kombëtar. Aktivitete të tjera që planifikohen (më 2 mars) është 574 vjetori i Besëlidhjes Shqiptare të Lezhës, 140 vjetori i Lidhjes së Prizrenit (në muajin qershor), 140 vjetori i lindjes së Hasan Prishtinës, 110 vjetori i Kongresit të Manastirit, por edhe data të tjera, si 90 vjetori i largimit të Nënë Terezës nga Shkupi, që do të shënohet edhe me ekspozita dhe publikime për historinë e shqiptarëve dhe familjeve katolike të Shkupit.

BLERJA E MERCEDESIT TË GRUEVSKIT SHQYRTOHET MË 12 SHKURT



“TANKU” ANULOHEH ENDE PA FILLUAR

I akuzuari Nikolla Gruevski ka shfrytëzuar pozitën dhe ndikimin e tij dhe ka kërkuar nga ministrja e atëhershme e Punëve të Brendshme, Gordana Jankullovska, të fillojë procedurën për blerjen e një veture të blinduar “mercedes”, vlera e të cilës kishte arritur në 600 mijë euro

Koha

Omer XHAFFERI


Shkup, 30 janar - Ndryshimet në ekipin e avokatëve të të akuzuarve në rastin “Tank”, ishte arsyeja kryesore se pse lënda e radhës gjyqësor kundër Nikolla Gruevski, Gordana Jankullovska dhe Gjoko Popovski, nuk u procedua nga Gjykata Penale e Shkupit. Ish-ndihmës ministri i Punëve të Brendshme, Popovski, përmes përfaqësuesit ligjor Bogolub Sofronievski, njoftoi se avokatin e kishte angazhuar një ditë para se kjo seancë të mbahej, me çka kërkoj anulimin e seancës. Koha e shkurtër dhe lënda voluminoze, siç nënvizoi avokati Sofronievski, paraqesin pengesën kryesore që ai ta përgatitë mbrojtjen e mirëfilltë dhe efektive kundrejt akuzave që i ngarkohen klientit të tij. “Ju lutem të më jepni edhe disa ditë kohë që ta shqyrtojë në detaje këtë lëndë, për shkak se vetëm një ditë ka kaluar që kur jam i angazhuar si avokati i klientit tim”, theksoi Sofronievski. Duke i respektuar të gjitha palët në procedura, kryetarja e Këshillit Penal, Dobrilla Kacarska, kërkoj mendim edhe nga përfaqësuesi i aktakuzës, në këtë rast nga prokurori special, Trajçe Pevivanov. Në emër të Prokurorisë Speciale

Publike, prokurori në fjalë tha se është i vetëdijshëm për të drejtat e të akuzuarve në procedurë, megjithatë kërkoj nga Trupi gjyqësor që t’ua tërheq vërejtjet të akuzuarve dhe avokatëve, dhe të mos bëjnë këso lloj ndryshimet pasi synimi i tyre është zvarritja e procesit gjyqësor. Blerja dhe hapja e procedurës furnizim të Ministrisë për Punë të Brendshme, me veturën “Mercedes” për nevojat ish kryeministrit Gruevski, paraqet bazën e aktakuzës për lëndën gjyqësore “Tank”, e cila mes tjerash - të akuzuarit i ngarkon për “keqpërdorim të detyrës zyrtare”. Ndryshe, në këtë aktakuzë qëndron se gjatë periudhës kohorë shkurt-tetor të vitit 2012, i akuzuari Nikolla Gruevski, si person zyrtar e ka shfrytëzuar pozitën dhe ndikimin e tij dhe ka kërkuar nga ministrja e atëhershme e Punëve të Brendshme, Gordana Jankullovska, të fillojë procedurën për blerjen e një veture të blinduar “mercedes” vlera e të cilit ka arritur deri në 600 mijë euro. Tutje, në aktakuzë thuhet se ish ministrja Jankullovska, për të përbushur këtë kërkesë, ajo e ka nxitur të akuzuarin (ish ndihmës ministrin, Gjoko Popovski), të bëjë vepër penale “keqpërdorim të autorizimeve zyrtare”. Shkeljet e

Ligjit për furnizime publike, siç nënvizohet në aktakuzë, janë bërë në atë drejtim të favorizimit të vetëm një operatori ekonomik “M.A”, nga i cili është kërkuar vetura specifike “Mercedes, C 600 gard”. Nga PSP, lidhur me këtë rast kanë thënë se të tre të akuzuarit, gjatë realizimit të kësaj procedure për blerje të veturës në fjalë, kanë qenë të vetëdijshëm për çmimin tejet të lartë, në kushte kur fuqia blerëse e MPB-së ka qenë shumë e ulët. Me qëllim zbardhjen e plotë të këtyre malverzimeve, LSDM gjatë vitit 2015 në njërin prej bombave të saj e publikoi bisedën mes dy progatonistëve kryesorë - Gruevskit dhe Jankullovsks. Në këtë bisedë, e cila buronte nga “bombat” - opinion pati mundësi të dëgjojë se si ish kryeministri Gruevski i kërkonte Jankullovsks blerjen e mercedesit. Ndryshe, e gjithë kjo procedurë deri në publikimin e bisedave nga përgjimet e jashtëligjshëm, në vitin 2015, për shumicën e mediave dhe publikut më të gjerë nuk ka qenë e njohur. Sidoqoftë, pas shumë presioneve dhe debateve publike, vetura në fjalë e cila është pjesë e kësaj lëndë, muaj më parë nga ana e udhëheqësisë aktuale të MPB-së është nxjerrë në shitje publike.

Shpëtohet gruaja që deshi të vetëvritet në Vardar

Shkup, 30 janar - Nga ujërat e Vardarit, në qendrën e Shkupit, dy persona paraqite arritën të shpëtojnë një grua të re. Gjatë tentimit për shpëtimin e gruas dhe njëri prej shpëtuesve u bllokua në tubat të cilat shihen në lum. Në vendin e ngjarjes arritën automjete të Ndihmës së shpejtë, të Njësisë Zjarrfikëse dhe policisë. Zjarrfikësit tentuan t’u ndihmojnë të dy shpëtuesve dhe gruas së re ta kalojnë lumin, sepse paraprakisht gjendeshin në ishullin që është formuar në vetë lumin. Një peshkatarë dëshmitarë okular i ngjarjes deklaroi se gruaja ishte hedhur në Vardar para Urës së Gurit.



KRONIKË

Arrestohet greku me 310 kilogramë marijuanë

Në vendkalimin kufitar Bogorodicë është arrestuar një shtetas grek, i cili më 28 janar ka transportuar drogë narkotike - marijuanë në sasi prej 309.6 kilogramë, e cila është dedikuar për shitje. I dyshuari drogën e ka transportuar në automjetet transportues “Skania” me targa greke nga Athina, Republika e Greqisë deri në Vupertal, Republika e Gjermanisë. Në automjetin mes mallit të llojllojshëm i dyshuari ka transportuar edhe 95 thasë oriz me destinacion përfundimtar Kerkade, Mbretëria e Holandës. Marijuana është gjetur e mbështjellë me folie plastike në 75 thasë, krahas orizit, informojnë nga Prokuroria Publike. Prokuroria Publike Themelore Veles, siç informon, solli urdhër për zbatim të procedurës hetuese kundër të dyshuarit për veprën e kryer penale - Prodhim i paaautorizuar dhe lëshim në qarkullim të drogave narkotike, substancave narkotike dhe prekursorëve nga neni 215 paragrafi 1 të Kodit Penal. Gjykata Themelore Veles të dyshuarit i ka caktuar paraburgim prej 30 ditësh.

Rrahje në Idrizovë, një i burgosur

Një i burgosur në burgun në Idrizovës ka marrë lëndime të rënda pasi është qëlluar nga një i burgosur tjetër. Siç kumtoi MPB-ja, incidenti ka ndodhur dje rreth orës 16:00 në Institucionin Ndëshkues - Përmirësues Idrizovë kur i burgosuri R.GJ (45) nga fshati Jurumleri, i Shkupit, është qëlluar në pjesën e hundës nga i burgosuri A.K. "R.GJ". i është ofruar ndihmë mjekësore në Qendrën e Urgjencës pranë kompleksit të klinikave "Nënë Tereza" në Shkup dhe i janë konstatuar lëndime të rënda trupore" theksojnë nga MPB-ja. Janë duke u ndërmerr masa për zbardhjen e plotë të rastit.

Sanksionohen 45 shoferë të shpejtë

Pesë persona janë lënduar më pak në tre nga gjithsej tetë aksidentet e regjistruara gjatë ditës së djeshme në rajonin e SPB-së Shkup. Në pesë është shkaktuar dëm material. Policia e komunikacionit ka sanksionuar 45 shoferë të cilët kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe nga shpejtësia e lejuar, një shofer i cili ka kaluar në udhëkryq në dritë të kuqe të semaforit, një shofer i cili nuk ka dhënë përparësi kalimi dhe një shofer për rreshtim në mënyrë të parregullt. Nga trafiku janë përjashtuar dy shoferë për shkak të drejtimit të automjetit nën ndikimin e alkoolit dhe shtatë të tjerë janë përjashtuar nga trafiku sepse kanë drejtuar automjetin para se ta marrin patentën, si dhe nëntë automjete me afat të skaduar të patentës për qarkullim. Është sanksionuar edhe një këmbësor i cili ka kaluar në udhëkryq në dritë të kuqe të semaforit. Janë hasur edhe 75 automjete të parkuara në mënyrë të parregullt. Me ndihmën e automjetit special “karrotreci” janë larguar 86 automjete.

(O.XH)

IMPORTI I NAFTËS

ASHPËRISOHEN
KRITERET

Janë evidentuar ikje të pagesës së kompensimeve ndaj shtetit dhe importin e vajit ekstra të lehtë që më vonë përfundon në pompat e benzinës si karburant dizel.

Keqpërdorimet e tilla do të parandalohen me Ligjin e ri për energjetikë i cili do të ashpërsojë kushtet se kush mund të jetë importues dhe shpërndarës i karburanteve në Maqedoni, duke i barazuar ato me standardet e Bashkimit Evropian

fitimin e licencave për import dhe distribuimin e karburanteve në Maqedoni. Të gjitha këto masa do të ndërmerren me qëllim të parandalimit të keqpërdorimeve të caktuara në të kaluarën kur kompani të caktuara kanë shitur vajin ekstra të lehtë për amvisëri (me akcizë prej 6.3 denarë) si dizel (me akcizë prej 15.4 denarë) që paraqet një dallim prej 9.1 denarë. "Jemi dëshmitar për keqpërdorime të mëdha lidhur me ikjen e pagesës së kompensimeve ndaj shtetit dhe importin e vajit ekstra të lehtë që më vonë përfundon në pompat e benzinës si karburant dizel. Një gjë e tillë duhet të luftohet për shkak se dëmton si arkën e shtetit ashtu edhe qytetarët. Andaj, Ligji i ri për energjetikë do të ashpërsojë kushtet se kush mund të jetë importues dhe shpërndarës i karburanteve në Maqedoni dhe do ti barazojë ato me standardet e Bashkimit Evropian", thotë zëvendëskryeministri për Çështje Ekonomike, Koço Angjushev.

VAJI EKSTRA I LEHTË, NDOTËSI I MADH I AJRIT

Sipas ambientalistëve vaji ekstra i lehtë në shumë shtete as që përdoret për ngrohje dhe si karburant i veturave për shkak të ndotjes së ambientit. Ata theksojnë se përderisa dizeli përmban 10 ppm grimca të sqfurit, vaji ekstra i lehtë përmban 1000 ppm grimca, andaj edhe është ndotës shumë i madh i ambientit.

Duke komentuar Ligjin e ri për energjetikë, një pjesë e kompanive kanë hapur edhe çështjen e fshehjes së tatimit dhe mospagesës së akcizës gjatë importit të karburanteve të një pjese të importuesve. Kjo ka qenë edhe arsyeja që Prokuroria Publike Themelore për ndjekjen e kimit të organizuar dhe korrupsionit, ka hapur procedurë para-hetimore lidhur me zërat për keqpërdorimin dhe fshehjen e tatimit gjatë importit të karburanteve të naftës. Nga kjo Prokurori konfirmojnë se ekziston

dishimi se është importuar mall i deklaruar si naftë për amvisëri, ndërsa në të vërtetë është importuar karburant i naftës, me çka i është shkaktuar dëm buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

Në ndërkohë kompanitë nga biznesi i naftës kërkojnë që të ketë një licencë të veçantë për magazinimin dhe distribuimin e naftës, me çka do të thjeshtësohen edhe kontrollet e inspeksioneve. Pikërisht ndër risitë që parashikohen me Ligjin e ri për energjetikë, është edhe rritja e kapaciteteve për magazinim e nevojshme për tregtinë me shumicë me naftë nga 50 deri 100 metra kub.

Bashkëpunimin
shëndetësor me
Bullgarinë

Shkup, 30 janar - Maqedonia dhe Bullgaria do ta intensifikojnë bashkëpunimin në shëndetësi, është dakorduar në takimin në Sofje ministrat dikasterial të të dy vendeve Venko Filipçe dhe Kiril Ananiev.

Nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Maqedonisë kumtuan se në takim është potencuar se Republika e Bullgarisë, e cila si anëtare e BE-së nga sivjet e ndërmerr kryesimin me Këshillin Evropian, i respekton të gjitha rregullativat juridike dhe bashkëpunimi i përbashkët paraqet hap të madh në drejtim të implementimit të standardeve evropiane në sistemin shëndetësor të Maqedonisë.

Gjithashtu, është dakorduar që në suaza të Ministrisë së Shëndetësisë të formohet grup pune i cili intensivisht do të punojë në implementimin e standardeve evropiane me mundësi të marrjes së ndihmës energjetike nga Republika e Bullgarisë për avancimin e shumë segmenteve nga sistemi shëndetësor konform standardeve të BE-së. Delegacionit të Maqedonisë, siç publikoi pala bullgare, i janë prezantuar ligjet për shëndetësi, për barna për mjekësi humane, për institucionet shëndetësore, për organizatat profesionale, për pajisjet mjekësore dhe Rregulloren për rregullimin dhe regjistrimin e çmimeve të barnave në Bullgari.

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 30 janar - Ligji i ri për energjetikë që pritet të miratohet deri në fund të muajit shkurt, do të sjellë kriteret më të rrepta për importin e naftës, që nënkupton vendosjen e kushteve më të rënda për

BEKTESHI TAKOI NË ANKARA MINISTRIN TURK, ZEJBEKIÇ

Rritje e bashkëpunimit ekonomik me Turqinë

Ankara, 30 janar - Maqedonia dhe Turqia do ta thellojnë bashkëpunimin ekonomik dhe do të nxitin tregtinë reciproke e cila në vitet e fundit shënon rritje, veçanërisht në pjesën e eksportit të Maqedonisë në tregun turk. Këtë e parashikon vendimi i Komitetit të përzierë të Marrëveshjes për tregti të lirë midis Maqedonisë dhe Turqisë, të cilën e nënshkruan ministri i Ekonomisë Kreshnik Bekteshi dhe kolegu i tij turk Nihat Zejbekçi. Me këtë Vendim, i nënshkruar gjatë vizitës së Bekteshit në Ankara, ndryshohet Protokollin 2 nga kjo marrëveshje për të krijuar dispozita për zbatimin e Konventës Rajonale për rregullativën Pan-Euro mesdhetare për origjinën e mallrave (PEM) dhe zgjerimin e mundësive për kumulim diagonal të origjinës së mallrave me vendet e tjera. Zbatimi i Konventës Rajonale, të cilën vendi ynë e ratifikoi në

maj të 2012 ndërsa Republika e Turqisë në nëntor të 2013, nënkupton krijimin e kushteve identike në zbatimin e rregullave të origjinës, me ç'rast kumulimi diagonal i origjinës së mallrave do të vlejë për vendet anëtare të BE-së, për ato vende të CEFTA që zbatojnë Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit dhe Shtetet e EFTA-s. Kumulimi diagonal sipas kushteve identike për rregullat e origjinës është përfitimi më i rëndësishëm për kompanitë maqedonase dhe turke të cilat do të mund të pajisen me EUR 1 certifikatë e origjinës preferenciale të mallrave për eksport, edhe pse riprodhimi, lënda e parë, gjysmë-produkti janë me origjinë nga vendet e BE-së, CEFTA ose / dhe EFTA, që nuk ka qenë rast më parë. Republika e Maqedonisë tanimë ka ndryshuar Protokollin mbi origjinën e mallrave me shtetet anëtare të BE që janë në fuqi

që nga shkurti 2017 dhe me vendet e CEFTA që janë në fuqi nga muaji shtator 2017. Me vendet e EFTA-s, negociatat për ndryshimin e Protokollit mbi origjinën e mallrave sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë janë në fazën përfundimtare. Ministrat Bekteshi dhe Zejbekçi u dakorduan që në periudhën e ardhshme të formojnë grupe ekspertësh nga të dyja vendet të cilët do të punojnë në modernizimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë, e cila do të mundësojë harmonizimin e saj me rregulloren për shërbime të Organizatës Botërore të Tregtisë dhe do të krijohet bazë për negociatat të reja në sektorin agro-ushqimor që do të jetë në interes të komunitetit të biznesit, ku si kapitull i veçantë do të jenë investimet. Në këmbimin tregtar të jashtëm të Republikës së Maqedonisë me botën, Republika e Turqisë ndodhet në vendin e 8-të për pe-



riudhën janar-nëntor 2017 dhe 2016, ndërsa para saj janë Gjermania, Britania e Madhe, Greqia, Ser-

bia, Bullgaria, Italia dhe RP e Kinës. Për periudhën janar-nëntor 2017, shkëmbimi i përgjithshëm

Është koha që shteti të mendojë për miratimin e një Ligji për falimentim personal, sepse aftësia paguese e kredive nga ana e qytetarëve dita ditës vetëm se po përkeqësohet, ndërsa bankat i çojnë qytetarët të fajdexhinjtë. Vitin e kaluar, qytetarët përmes kredive bankare kanë borxh 200 milionë euro, kurse për mbulim të minusit duhet të llogariten edhe 96 milionë euro

PASOJAT E MOSKTHIMIT TË KREDIVE

BANKROTI PERSONAL, ZGJIDHJA E VETME



PAVLE GACOV

Kriza e rëndë ekonomike në Maqedoni pesë vitet e fundit rëndë ka prekur të ardhurat e qytetarëve dhe tani ata nuk kanë para për të kthyer kreditë. Kjo situatë bënë që shumë qytetarë të futen në kredi të reja edhe pse kanë të ardhura të ulta mujore që do të thotë se paga e tyre mujore e tyre aspak nuk përkon me shpenzimet mujore të planifikuara

paguan borxhet e vjetra", thotë Pavle Gacov, ekspert ekonomik.

KUR FAJDET ZËVENDËSOJ NË KREDITË!

Eksperti për çështje ekonomike Sinisha Pekevski, thotë se mungesa e kulturës dhe e vetëdijes qytetare për arsyen e marrjes së kredisë dhe mungesa e menaxhimit të mirë të parasë, shpesh i vë në vështirësi familjet për kthimin e kredive.

"Në kushte normale, qytetarët përmes kredive gjejnë financim për diçka, që në fakt, në rrethana të tjera e kanë pasur të pamundur. Kjo i bënë ata shpesh të futen në spiralen e marrjes së kredive të reja dhe aq lehtë mund t'i kthejnë kredit dhe si opsion tjetër të vetëm e kanë marrjen e kredive të reja nga institucionet mikro financiare me kamata dy herë më larta se bankat komerciale apo nga fajdexhinjtë, që të kthejnë kreditë e vjetra. Pastaj ofertat e shumta të bankave për kredi konsumatore me kamata të ulta mundësoi ekspansimin e qytetarëve të marrin këtë lloj kredie pa

pasur plan se a do mundet në kohë t'i kthejë këstet e kredive me pagat mujore që ata marrin. Mendoj se para se shteti të intervenon dhe të sjellë ligj për bankrot personal më se e nevojshme është edukimi financiar i qytetarëve sepse mungesa e kulturës dhe e vetëdijes qytetare për arsyen e marrjes së kredisë dhe mungesa e menaxhimit të mirë të parasë shpesh i vë në vështirësi familjet për kthimin e kredive", thotë Sinisha Pekevski, ekspert ekonomik.

Të dhënat e fundit të Bankës Qendrore të Maqedonisë vitin e kaluar qytetarët përmes kredive bankare kanë borxh 200 milionë euro, kurse për mbulim të minusit duhet të llogarisë 96 milionë euro. Shikuar sipas llojeve të kredive vitin e kaluar, qytetarët kryesisht kanë marrë kredi konsumatore me vlerë mbi 1.8 miliard euro dhe kredi për banim rreth gjysmë miliardë euro. Interesi për kredi për makina është më i dobët, ku shumica e përgjithshme vitin e kaluar ishte 10 milionë euro.

Aktivizohen masat për ndotjen e ajrit, Shkup në alarm

Shkup, 30 janar - Sipas të dhënave të Sistemit shtetëror automatik monitorues për cilësinë e ajrit ambiental dhe parashikimin e fituar të motit nga Drejtoria e Punëve Hidrometeorologjike, pragu i alarmimit për PM10 (tejkallim i vlerës prej 200 mg/m3 gjatë dy ditëve me radhë) më 28 dhe 29 janar është tejkaluar në Shkup në vendet e matjes te Rektorati, Lisiçe dhe në Gazi Babë. Këtë e kumtuan nga shërbimi qeveritar për informim prej nga thonë se nga ana e Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor është dorëzuar informacion për tejkallimin e pragut të alarmimit deri te Ministria e Shëndetësisë dhe Punës dhe Politikës Sociale, Inspektorati Shtetëror për Mjedis Jetësor, Drejtoria për Mjedisin Jetësor, Sektori për komunikim me opinionin e MMJPH, Instituti për Shëndet Publik, Qyteti i Shkupit dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale ku ka episod të ndotjes alarmante të ajrit. Në pajtim me konkluzionet nga procesverbali nga seanca e 40-të e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë e mbajtur dje hynë në fuqi rekomandimet dhe masat. Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë janë të obliguar t'u rekomandojnë të gjitha subjekteve juridike (punëdhënësve) t'i lirojnë prej punës gratë shtatzëna, personat mbi 60 vjeç, si dhe personat me astmë kronike, me infarkt të pësuar miokardial ose tronditje në tru, pa dallim moshës, me rekomandim të mjekut amë.

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 30 janar - Nëse para dy viteve qytetarët e Maqedonisë për të gjetur financa shtesë për të siguruar mirëqenie familjes së tyre e gjenin të marrja e kredive nëpër bankat komerciale, vitin e fundit për shkak të pamundësive financiare për të kthyer kreditë e vjetra tani qytetarët po u drejtohen disa institucioneve mikro financiare që ofrojnë kredi me vlerave të ulta prej 100 euro deri më 1500 euro, me afat kthimi brenda një muaji e deri më 8 muaj. Ky aktivitet i institucioneve mikro financiare brenda një viti, sipas ekspertëve ekonomikë, është rritur shumë për shkak se qytetarët detyrohen të gjejnë alternativa tjera se si të vijnë deri të parat e reja për pak kohë duke mos pyetur se sa të shtrenjta janë këto kredi të cilat dita ditës në Maqedoni vetëm se shtohen.

Arsyeja kryesore se pse qytetarët shpëtimin e gjejnë tek këto institucione mikro financiare, sipas ekspertit ekonomik Pavle Gacov, është për shkak tkurrjes së kredidhënëve nga bankat komerciale, si pasoje e përkeqësimit të kthimit të kredive të marra nga një numër i madh i qytetarëve. Gacov është i mendimit se është koha që shteti të mendon për miratimin e një ligji për falimentim personal, sepse aftësia paguese e kredive nga ana e qytetarëve dita ditës vetëm se po përkeqësohet.

PAGA MUJORE NUK PËRKON MESH PENZIMET MUJORE

"Kriza e rëndë ekonomike në Maqedoni pesë vitet e fundit rëndë ka

prekur të ardhurat e qytetarëve dhe tani ata nuk kanë para për të kthyer kreditë. Kjo situatë bënë që shumë qytetarë të futen në kredi të reja edhe pse kanë të ardhura të ulta mujore që do të thotë se paga e tyre mujore e tyre aspak nuk përkon me shpenzimet mujore të planifikuara", thotë Gacov.

Në një pamundësi për gjetjen e alternativave tjera për të gjetur para plotësuese jashtë rrogës mujore për të kthyer kreditë e vjetra, bankat komerciale po i detyrojnë qytetarët drejt institucioneve mikro financiare që japin kredi me kamata dy herë më të larta se bankat apo të marrin hua nga fajdexhinjtë.

"Ka situata kur njerëzit nuk mund të paguajnë kreditë, sepse atyre shpesh u ndodhë që me pagën mujore që marrin nuk arrijnë të sigurojnë gjërat elementare për mbijetesë të familjes. Prandaj mendoj se është koha që shteti të fillojë të mendojë për një ligj mbi falimentimin personal. Në vendet zhvilluara falimentimi personal është një gjë e zakonshme, sepse nëse një qytetar dështon në kthimin e kredive kjo për debitorin është një dështim i vogël. Nëse një qytetar do të shpallte bankrot personal në përputhje me ligjin atëherë kreditori nuk mund të paguajë as një borxh të qytetarët. Kështu qytetari i cili shpall bankrot personal mund të mbledhë një përqindje të caktuar ta parave dhe të

Shëndetësia e Maqedonisë në vendin e 22-të në Evropë

Shkup, 30 janar - Sistemi shëndetësor i Maqedonisë është renditur në vendin e 22-të në listën e sistemeve shëndetësore evropiane për vitin 2017. Në listën që e publikoi Indeksi Konsumator Shëndetësor Evropian, Maqedonia ka 649 pikë. Në vendin e parë në listë është Holanda, në vendin

e dytë është Zvicra, ndërsa në të tretin është Danimarka. Më mirë të renditura se Maqedonia janë Serbia në vendin e 21-të dhe Sllovenia në vendin e 16-të. Pas Maqedonisë në listë janë Mali i Zi në vendin e 25-të, Kroacia në vendin e 26-të, Shqipëria në vendin e 27-të, Greqia në 32-shin dhe Bullga-

ria në vendin e 33-të. Në sy vendet e fundit janë Rumania dhe Qiproja. Sipas Indeksit Konsumator Shëndetësor Evropian, Maqedonia në vitin 2013 ka qenë në vendin e 27-të, ndërsa në vitin 2014 ka përparuar në vendin e 16-të. Progresi kryesisht është arritur për shkak të vendosjes së Siste-

mit kombëtar për evidenca elektronike në shëndetësi "Termini im" dhe ulja e listave të pritjes. Vërejtje ka në zbatimin praktik të këtij sistemi, si dhe në metodat e vjetruara të kurimit, e mbetur që nga koha e ish Jugosllavisë. Indeksi Konsumator Shëndetësor Evropian i analizon sistemet

shëndetësore kombëtare në bazë të treguesve 48 të cilët përfshijnë fusha, siç janë të drejtat dhe informimi i pacientëve, qasja drejt mbrojtjes shëndetësore, rezultatet nga kurimi, dhe zona e shërbimit, parandalimi dhe përdorimi i prodhimeve farmaceutike.

Në bazë të neneve 125 dhe 131 të Ligjit për Arsimin e Lartë (Gaz. Zyrtare e RM-së nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145/15, 154/15, 30/16, 120/16 dhe 127/16), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës si dhe në mbështetje të nenit 144 të Statutit të Universitetit të Tetovës, shpallet

KONKURS

Për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore shkencore, profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës
Shpallet Konkurs për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore, profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës:

FAKULTETI I SHKENCAVE TË ZBATUARA

- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Projektimi dhe ndërtimi i rrugëve
 - Organizimi i ndërtimit dhe mekanizimi
 - Planifikimi i infrastrukturës
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Konstruksiione arkitektonike 1A
 - Konstruksiione arkitektonike 2A
 - Konstruksiione arkitektonike 3A
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Rregullimi teknik
 - Teknologjia prodhuese në mekatronikë II
 - 3D inxhinieria

FAKULTETI I BUJQËSISË DHE BIOTEKNOLOGJISË

- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Bazat e prodhimit bimore
 - Fitopatologji
 - Fitofarmaci

FAKULTETI PEDAGOGJIK

- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Letërsi për fëmijë
 - Gjuhë shqipe
 - Didaktika e fushave gjuhësore me praktikë pedagogjike
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Hyrje në edukim special dhe rehabilitim
 - Praktikë inkluzive
 - Vështirësitë në të mësuar
 - Pedagogji speciale
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Didaktika e artit figurativ me praktikë I dhe II
 - Historia e artit
 - Loja skenike
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Hyrje në pedagogji
 - Pedagogjia e përgjithshme
 - Komunikologjia pedagogjike
 - Pedagogjia (në programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Angleze)
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Mësimi i përgjithshëm
 - Sistemet arsimore
 - Andragogji
 - Didaktika andragogjike

FAKULTETI FILOZOFIK

- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Psikopatologjia speciale
 - Psikopatologjia e fëmijërisë dhe rinisë
 - Psikologji klinike
 - Psikologji mjekësore
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Shkencat ndihmëse të historisë
 - Metodologjia e historisë
 - Historia e mesjetës I dhe II
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Historia e popullit shqiptar III
 - Historia botërore - bashkëkohore
 - Historia e përgjithshme (në Fakultetin Pedagogjik)
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Teoria e personalitetit
 - Psikologjia e fëmijërisë dhe rinisë
 - Psikologjia e pjekurisë dhe pleqërisë
 - Statistika e psikologjisë
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Politika sociale
 - Sociologji rurale
 - Sociologji urbane

FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE

- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Mjekësi interne I dhe II
 - Kineziologji

FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE

- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Fizika e përgjithshme III
 - Fizika bërthamore
 - Fizika mjekësore (në programin studimor Stomatologji)
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Kimi fizike I dhe II
 - Kimi fizike (në programin studimor Farmaci)
 - Kapituj të zgjedhur nga Kimia fizike
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Kimi e përgjithshme I dhe II
 - Kimi mjekësore (në programin studimor Mjekësi e përgjithshme)
 - Kimi e përgjithshme dhe inorganike (në programin studimor Biologji)
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Kimi analitike I dhe II
 - Kimi analitike (në programin studimor Farmaci)
 - Kimi analitike (në programin studimor Biologji)
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Gjeografia turistike
 - Rajonet turistike në botë

- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Analiza matematike IIA dhe IIB
 - Matematika në ekonomi
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Struktura diskrete I dhe II
 - Algjebër lineare I
 - Matematika (në programin studimor Farmaci)
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Analiza matematike IA dhe IB
 - Kalkulus (në programin studimor Informatikë)
 - Statistika e zbatuar (në programin studimor Farmaci)
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Kurrizorët
 - Anatomi e krahasuar
 - Ekologji animale me zoogeografi
- Një asistent-doktorant për lëndët mësimore në fushën e informatikës.

FAKULTETI EKONOMIK

- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Kërkimet e tregut në turizëm
 - Bazat e menaxhmentit
 - Bazat e marketingut
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Hyrje në ekonomi
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Menaxhimi i burimeve njerëzore
 - Menaxhmenti hotelier
 - Menaxhmenti restorantor
- Një asistent-doktorant për lëndët mësimore në fushën e ekonomisë.

FAKULTETI JURIDIK

- Një mësimdhënës për lëndët:
 - E drejta civile – pjesa e përgjithshme
 - E drejta e shoqërive
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - E drejta e procedurës penale
 - Bazat e sistemit gjyqësor
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Të drejtat e njeriut
 - Zgjedhjet dhe sistemi zgjedhor
 - Hyrje në të drejtën (programi studimor Studime politike)
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - E drejta publike (Gezataria dhe media)
 - Historia e institucioneve (në programin studimor Studime politike)
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Marrëdhëniet ndërkombëtare
 - Ekonomia politike ndërkombëtare I dhe II
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - E drejta ndërkombëtare private
 - Liritë dhe të drejtat e njeriut
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Organizatat ndërkombëtare
 - Zgjidhja paqësore dhe jashtëgjyqësore e kontesteve
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Redaktimi në media
 - Teoritë e modernizmit dhe mediat globale
 - Komunikimi dhe marrëdhëniet ndërkombëtare
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - E drejta sendore (reale)
 - E drejta familjare dhe trashëgimore
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Teoria dhe praktika parlamentare
 - E drejta administrative
 - E drejta kushtetuese krahasuese
- Një asistent-doktorant për lëndët mësimore në fushën e së drejtës.

FAKULTETI FILOLOGJIK

- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Metodika e mësimdhënies së gjuhës angleze I, II dhe III
 - Planifikimi i orës mësimore I dhe II
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Bazat dhe teknikat e hulumtimit shkencor
 - Shkrim akademik në anglisht I dhe II
 - Mësimdhënja e gjuhës angleze dhe teknologjitë bashkëkohore
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Sintaksa I dhe II
 - Historia e gjuhës shqipe
 - Drejtshkrimi I dhe II
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Letërsia botërore I dhe II
 - Drama dhe teatri shqiptar
 - Eseiistikë
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Letërsi për fëmijë I dhe II
 - Teoritë letrare
 - Shkrim akademik
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Morfologji I dhe II
 - Leksikologji I dhe II
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Letërsia e vjetër shqipe I dhe II
 - Letërsia krahasimtare I dhe II

- Analizë dhe interpretim
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Letërsi angleze VII
 - Letërsi angleze VIII
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Letërsi popullore I dhe II
 - Mitologjia

FAKULTETI I ARTEVE

- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Skulpturë A1, A2, A3 dhe A4
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Akt 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Pikturë 1, 2, 3, 4 dhe 5
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Teoria figurative I dhe 2
 - Anatomi plastike I dhe 2
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Pikturë I dhe 2
 - Metodika e kulturës figurative
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Vizatim I dhe II
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Histori arti 5, 6, 7 dhe 8
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Grafikë reklamuese 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Përgatitja e librit
 - Shkrimi me topografi 1, 2 dhe 3
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Histori arti 1, 2, 3 dhe 4
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Metodika e mësimi të muzikës 1, 2, 3 dhe 4
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Polifoni vokale I dhe 2
 - Polifoni instrumentale I dhe 2
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Piano OBL 1, 2, 3 dhe 4
 - Metodika e pianos 1, 2, 3 dhe 4
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Teknikë vokale I dhe 2
 - Histori muzike 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6
 - Solo këndim 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Filozofi arti
 - Sociologji arti
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Aktrim
 - Të folurit skenik me teknikë zëri

Kushtet për thirrjen mësimore-shkencore dhe profesionale docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar:

- Thirrje mësimore – shkencore, me Vendim të organit kompetent-Këshillit mësimor– shkencor të institucionit të arsimit të lartë, nëse e posedon;
- Diplomë për gradën shkencore-doktor i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;
- Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
- Biografi e shkurtër;
- Ta dorëzojë punimin e doktoratës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- Certifikatë e shtetësisë.

Kushtet për thirrjen asistent – doktorant:

- Diplomë për kryerjen e arsimit të lartë dhe marrjen e gradës shkencore magjistër i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet, si dhe dëshmi për regjistrimin e studimeve të doktoratës;
- Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
- Biografi e shkurtër (CV);
- Ta dorëzojë punimin e magjistraturës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- Certifikatë e shtetësisë.

*Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, të parapara me nenin 125 të Ligjit për Arsimin e Lartë.

*Fletëparaqitjen bashkë me dokumentet e nevojshme, kandidati duhet t'i dorëzojë në

afat prej 5 ditë pune, nga dita e shpalljes së Konkursit, në Rektoratin e Universitetit të Tetovës, në adresën: Rektorati i Universitetit të Tetovës, Rr. e Ilindenit, p.n. Tetovë.

Tetovë, 30.01.2018
Universiteti i Tetovës

Skënderbeu, personaliteti i pakontestueshëm dhe përmasa e tij mbarëkombëtare e ndërkombëtare

Prof.dr Vebi BEXHETI



Viti në të cilin sapo kemi hyrë na erdhi me jubileun e 550 vjetorit të vdekjes së heroit kombëtar, Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Para plot 50 vitesh, kur po festohej 500 vjetori i ndarjes nga jeta e heroit tonë me përmasë edhe botërore, edhe pse në kushte krejt tjera politike, në fytyrat e zemrat e shqiptarëve, vërehej, gëzim e hare, krenari e mburrje për përkatësinë e tyre të kombit të njëjtë me atë të Skënderbeut të madh. Në ato vite të largët, kur gëzimin e shënimit të atij përvjetori na e kufizonin autoritetet jugosllave e në shumë vende edhe na e pamundësonin që ta shprehim haptas atë, në trojet shqiptare, edhe pse të ndara me mure, vërehej atmosferë, dashurie e respekti nga të gjithë shqiptarët, pa dallim rajoni, shteti, dialekti e feje, të vetëdijshëm se personaliteti i Skënderbeut të madh ishte e vetmja figurë që i bashkonte shqiptarët, ashtu si i bashkoi ato në Besëlidhjen historike të Lezhës.

Sot, pas plot 50 vitesh, shënimi i përvjetorit të Skënderbeut, edhe pse në kushte krejt tjera politike, kur kufijtë mes shqiptarëve janë vetëm vija administrative e jo mure ndarëse, sikur vërehet një zbehje e këtij manifestimi, gjithsesi jo si rezultat i ndonjë kufizimi nga qeveritë e shteteve ku jetojnë shqiptarët, por nga qarqe të ndryshme të vetë shqiptarëve. Me manipulime të ndryshme nga forca historikisht të njohura antishqiptare, dhe përmes falsifikimit të historisë, ato tentonin t'i zhveshin shqiptarët nga realiteti historik me tërë vlerat humane, siç është edhe heqja dorë nga vetitë pozitive të kombit që i përkisnin dhe sakrificat për mbrojtjen e qenies së tyre. Nën ndikimet e këtylla, përfshirë edhe keqpërdorimin e fesë për të hequr dorë edhe nga personalitetet e famshme të të njëjtit gjak, por me fe të ndryshme, për fat të keq u arrit që në masë jo edhe aq të vogël të futet huti e përçarje mes shqiptarëve. Si rezultat i futjes së këtij fitili, ku të parët, viktimë ishin individët me shkollim jo të kompletuar, por edhe një numër të kufizuar intelektualësh, pa përjashtuar edhe disa ekstremistë muslimanë, të cilët mendojnë se përkatësia kombëtare nuk është asgjë para asaj fetare, erdhi deri te tendenca për injorim të këtij përvjetori nga disa qarqe, të pavetëdijshëm së mohimi i

Skënderbeut është edhe mohim i vetvetes. Jo rastësisht i përmenda ekstremistët muslimanë, për t'i dalluar nga besimtarët e mirëfilltë e të devotshëm, për të cilët, para zotit të gjithë njerëzit janë të barabartë, pavarësisht dallimeve racore, klasore, fetare etj.

Falë dy figurave, shqiptare, të njohura botërisht si dy personalitete që çdo komb në botë do dëshironte t'i kishte, Skënderbeut dhe Nënë Terezës, por jo vetëm, sot shqiptarët, kudo që jetojnë, mburren me përkatësinë kombëtare të tyre sepse këto figura dhe shumë të tjera, me kohë e kishin rrënuar paragjykimin se shqiptarët janë primitivë, pa identitet dhe pa asnjë qytetërimin. Sa herë që fama e personalitetëve të këtyllë i pushton majat e qytetërimeve botërore duke u dhënë grusht të gjithë armiqtë të përbetuar, aq më të rrezikshëm bëhen lugetërit që në emër të pseudoshkencës dhe keqpërdorimit të Islamit që realisht bazë e ka mirëkuptimin dhe tolerancën ndërfaqetare, i shpallin luftë të ashpër edhe Nënës Terezë edhe Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Ka kohë që

kjo agoni mes dilemës së disave se është apo jo Skënderbeu Hero kombëtar apo vetëm një armik i përbetuar i muslimanëve. Kjo tezë tërësisht joshkencore, johumane, madje antikombëtare, e përgatitur shekuj me radhë nga qendrat më antishqiptare, e që u lëshohet një kategori shqiptarësh si patate e nxehtë në duart e tyre, assesi nuk mund ta fitojë betejën mbi të vërtetën e përligjur nga më tepër 1000 tituj të vprave shkencore e artistike zhanresh të ndryshme, të shkruara nga autorë shqiptarë dhe të huaj, të verifikuara në bibliografinë e vitit 1968, të përpiluar nga albanologu Androkli Kostalari me bashkëpunëtorët, botuar në Tiranë, me rastin e 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut.

Tendenca e zhveshjes së figurës së Skënderbeut nga karakteri kombëtar, duke afirmuar gjoja të vetmin qëllim të tij, luftën kundër islamit dhe mbrojtjen e krishterimit, jashtë kontekstit të realitetit sepse Perandoria Osmane qëllim kryesor e kishte pushtimin e hapësirave të reja, ndërsa besimi islam ishte vetëm pjesë e kulturës së tyre dhe besim të ci-

Sot, pas plot 50 vitesh, shënimi i përvjetorit të Skënderbeut, edhe pse në kushte krejt tjera politike, kur kufijtë mes shqiptarëve janë vetëm vija administrative e jo mure ndarëse, sikur vërehet një zbehje e këtij manifestimi, gjithsesi jo si rezultat i ndonjë kufizimi nga qeveritë e shteteve ku jetojnë shqiptarët, por nga qarqe të ndryshme të vetë shqiptarëve



lit i përkisnin, është e pa bazuar, antihistorike dhe antishkencore. Për fat të keq këtë mashtrim sot aq lehtë e gëlltisin edhe disa shqiptarë, të cilët të frymëzuar edhe nga keqpërdoruesit e islamit, i mohojnë tërësisht vepimet organizative luftarake, politike e diplomatike të Skënderbeut, që ishin në interes të formimit të shtetit të Arbërit, duke i veshur heroit kombëtarë vetëm vetitë e "Kryqëzatatave" dhe të udhëheqësit të tyre i cili i paska prerë e vrrarë të gjithë shqiptarët jo muslimanë!? Kjo çmenduri për këto të pavërteta, madje të llah-tarshme do thosha, vështirë se mund të kalojnë aq lehtë tek ata që ende qarkullon edhe një pikë gjaku shqiptar. Ky përvjetor jubilar për Skënderbeun me gjithë lirinë e manifestimeve të ndryshme në kushte demokratike, e atmosfere zyrtare shtetërore, për fat të keq aty-këtu shoqërohet edhe me këto të pavërteta jo të qëndrueshme por të dëmshme, që përveç shumë vetive negative që i veshin, Skënderbeun, nipin e Gradecit të Pollogut të Tetovës, e konsiderojnë edhe si djalin e serbes Vojsavë. E tërë kjo huti, përveç devijimeve me

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypsi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e maritë 30 janar | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

prapavijë, vjen edhe nga mosnjohja e rrethanave shoqërore të kohës dhe rolit të fesë në periudha e kushte ende të pakonsoliduara të kombit, por që nuk do të thotë se me një emër me karakter fetar krishterë ortodoks, të ngjashëm me atë të serbëve, duhet të jesh serb, ashtu siç nuk do të thotë se me një emër arab, duhet të jesh arab.

Po t'u kthehemi veprave, kushtuar Skënderbeut, nga ato të mirëfillta shkencore e deri te krijimet artistike, siç është ai letrar, muzikor pamor, apo edhe kinematografik, të autorëve shqiptarë dhe të huaj, ku gjithsesi nuk mungojnë edhe ato të krijimeve popullore, do e konstatojmë shumë më tepër praninë e elementit kombëtar, që nga bashkimi i princave dhe principatave për formimin e Shtetit të Arbërit, e deri te luftërat 25 vjeçare, se sa atë thjeshtë fetar të krishterë. Ky prijës dhe strateg i luftës, që i kaloi përmasat e luftëtarit të realtë, për t'u ngritur në mitologji, gjë që është e zakonshme për figurat, siç ishte Gjergj Kastrioti, Skënderbeu, betejat i zhvillonte me flamurin që në mes të fushës e kishte shqipen dykrenare, të ngjashëm me këtë të sotmin, simbolin e të gjithë shqiptarëve, e jo kryqin e kryqëzatave. Gjithsesi duke mbrojtur tokat e Arbërit, e veçmas epiqendrën e tyre, Krullin, Skënderbeu me Aleatët, mbronte njëherësh edhe pjesë të Evropës, që ishin synim i ushtrisë pushtuese të Perandorisë Osmane, gjë që nuk e dobëson fare karakterin kombëtar të këtij heroi, përkundrazi e zgjerojnë përmasën e tij nga kombëtarja, në ndërkombëtare. Praninë e personazhit të kësaj figure në letërsi, fillimisht do e konstatojmë në atë shqipe, pikërisht se vepra e parë kushtuar atij, është ajo e Marin Barletit, baskëkohanikut të tij, që u bë pikë referimi për të gjithë autorët tjerë të mëvonshëm, shqiptarë dhe të huaj. Në këtë veprë të botuar në Venedik, brenda viteve 1508-1510 në gjuhën latine, me titull "Historia e jetës dhe e bëmave të Skënderbeut, princit të Epirit", këtë figurë e konsideron simbol dhe thelb të qendrës ndaj sundimit të huaj. Një veprë tjetër, po ashtu e shkruar në latinisht, ku i jepet më tepër rëndësi aspektit kombëtar të Skënderbeut, është ajo e Frang Bardhit, kushtuar jetës dhe veprës së kryeheroit tonë. Vepra e botuar po në Venedik më 1636, u shkrua për ta hedhur poshtë pretendimin e peshkopit boshnjak Tomeo Marnaviqit se Skënderbeu qenqesh me prejardhje nga familja e tij. Albanologu Robert Elsie, kur flet për këtë veprë, ndër të tjera thotë se është një veprë erudite dhe me ndjenja të fuqishme kombëtare.

Gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare figura e Skënderbeut ishte në qendër të shumë veprave letrare, ku më tepër përshkruhej aktiviteti i tij kombëtar, që njëherësh ishte edhe frymëzim për shumë krijues të kësaj kohe. Në Poemën "Historia e Skënderbeut", që me të drejtë u quajt edhe testament politik i romantikut të madh rilindës, Naim Frashërit, poeti ynë, ndër të tjera thotë se ky hero e siguron lirinë e vendit duke i dhënë emër të pavdekshëm atdheut, duke e vënë në ballë të përpjekjeve të qytetërimit kundër invaduesve rrënimtarë osmanë. Fan Noli në vitin 1949 e ribotoi

veprën Historia e Skënderbeut, të botuar fillimisht më 1921. Në veprën e ribotuar ai shfrytëzoi edhe shumë burime të reja shkencore që kishte gjetur nëpër arkiva të huaja, siç ishte edhe ai i Vjenës, që nuk i kishte pasur në botimin e parë, dhe shënime të ndryshme të kronikanëve turq. Edhe në veprat e dy botimeve të Nolit, më tepër shkëlqen aftësia luftarake e heroit, bazuar edhe në artin luftarak të popullit dhe rolin e luftëtarëve shqiptarë për të themeluar dhe mbrojtur shteti e Arbërit.

Fenomeni i pranisë së figurës së Gjergj Kastriotit në Letërsinë arbëreshe është e veçanta e kësaj letërsie të kombit të ndarë. Arbëreshët e Kalabrisë, Sicilisë dhe disa krahinave tjera të Italisë, përveç veçorive siç është, gjuha, tradita, veshja, kënga dhe ritet e ndryshme familjare, që e mbajtën gjallë gjakun e shpërndarë të Arbërit, ajo që i lidhi përgjithshëm me trungun e të parëve ishte pikërisht kjo figurë qendrore, me emrin e të cilit arbëreshët me kohë e kishin identifikuar qenien e vet dhe fatin e tyre që i mbajti gjallë deri në ditët e sotme. Kjo pjesë e letërsisë sonë e periudhës së Rilindjes, pa e përjashtuar edhe këtë më të renë, sikur dilte e paplotësuar pa historinë e "Motit të madh" dhe kryepersonazhit të saj, Gjergj Kastriotin - Skënderbeun. Romantiku ynë i parë, poeti i madh, Jeronim de Rada, gati se në të gjitha veprat e tij më të rëndësishme, siç janë: Këngët e Milosaut, Skënderbeu i pafan, Serafina Topia, Psqyrë e një jete njerëzore etj., e trajton temën e periudhës skenderbeje, përfshirë edhe luftën e drejtë të heroit kundër pushtuesve osmanë dhe rezistencën 25 vjeçare, në mbrojtje të shtetit të Arbërit. Poema "Kënga e sprasme e Balës" e Gavril Darës, të Riut, Skënderbeun edhe pse jo si personazh kryesor, e paraqet me tërë vetitë pozitive të një udhëheqësi të luftës dhe respektin që ai kishte për ushtarët e thjeshtë. Bernard Bilota gjithashtu e përpunoi temën aq të preferuar të Skënderbeut. Ai në veprën e vet "Shpata e Skanderbekut ndë Dibrët Poshtë", më tepër i përkushtohet personazhit të kryeheroit, me tërë vetitë pozitive të tij dhe motivin atdhetar që e karakterizonte atë si strateg lufte, në betejën e parë të tij me ushtrinë osmane, që u zhvillua në Dibër të Poshtme.

Kjo trajtesë kishte për qëllim figurën e pakontestueshme të heroit tonë kombëtar - Skënderbeut, tendencën e disa qarqeve mjerane për mohimin e luftës atdhetare të tij dhe praninë e këtij personaliteti në veprat kryesore të disa autorëve shqiptarë, nga Marin Barleti, tek ata të Rilindjes Kombëtare e më vonë. Me këtë rast, kur po e shënojmë e 550 vjetorin e vdekjes, u përmendën vetëm një numër i kufizuar i veprave që e trajtuan këtë personalitet. Veprat që i theksuam dhe qindra e qindra të tjera të letërsisë shqipe e botërore, pa i përjashtuar edhe ato shkencore dhe ato të letërsisë popullore, që kryesisht Skënderbeun, këtë figurë historike kombëtare e ndërkombëtare e paraqesin personazh tërësisht pozitiv, me tërë vetitë e një luftëtari atdhetar, duhet t'i ndërpresin njëherë e përgjithmonë imputimet negative të disa qendrave që mundohen t'ia veshin kësaj figure qendrore kombëtare.

Nevoja për nivelizimin dhe qëndrueshmërinë e pagave në sektorin publik

Konfliktet më shpesh linden mes individëve dhe grupeve sipas interesave dhe dëshirave të ndryshme. Një ndër burimet kryesore të konflikteve në shoqëri janë: dallimet, kundërtënit, marrëdhëniet kontestuese, statusi etj. Si burime më të shpeshta të shumë konflikteve dhe pakënaqësive që paraqiten në shoqëri dhe shpijnë deri në revolta dhe diskriminime janë: raportet, kontestet dhe dallimet ekonomike, financiare dhe politike. Kjo, posaçërisht vlen për disa nga llojet e politikave publike, siç janë: politikat rregullative dhe redistributive.

Gjendja e vështirë ekonomike dhe statusi juridiko-politik i individëve dhe grupeve të ndryshme në shoqëri, bëjnë trysni dhe përpjekje deri tek institucionet e sistemit që të ndryshojnë politikën rregullative ndaj këtyre shtresave të pakënaqura dhe të diskriminuara në shoqëri. Po ashtu edhe vetë ndryshimet dhe konfliktet sociale i stimulojnë kërkesat për të ndërmarrë veprime konkrete nga ana e institucioneve përkatëse, siç janë kuvendi dhe qeveria. S'do mend se çështja e pagave mujore në sektorin publik dhe shtetëror është një fushë specifike e cila mbështetet në ligj dhe në akte nënligjore. Në Republikën e Maqedonisë kemi tre ligje në fuqi të cilat e rregullojnë fushën e marrëdhënies së punës, edhe atë: ligji për marrëdhënie pune, ligji për nëpunës publik dhe ligji për nëpunës administrativ. Po ashtu kemi edhe një sërë aktesh nënligjore (rregullore për sistematizim) të cilat në mënyrë më të detajuar e përshkruajnë dhe rregullojnë fushën për marrëdhënie pune. Nevoja për nivelizimin dhe standardizimin e pagave në sektorin publik lind për shkak të dallimeve të mëdha që ekzistojnë në pagat mujore. Kemi pabarazi tek nëpunësit të cilët për punë të njëjtë, në sektor të njëjtë, por të punësuar në institucione të ndryshme marrin paga mujore krejtësisht ndryshe!

Në Republikën e Maqedonisë kemi dy lloje të organizatave administrative, të cilat mund t'i klasifikojmë në: organizata që kon-

sistojnë në ushtrimin e pushtetit (administrata klasike shtetërore) dhe organizata që ushtrojnë shërbime të caktuara publike (administrata publike, nocioni më i përgjithshëm). Në grupin e parë, pagat mujore për nëpunësit administrativ janë të caktuara në ligjin për nëpunës administrativ. Këto paga janë dukshëm më të vogla në krahasim me grupin e dytë, ku bëjnë pjesë organizatat dhe institucionet të cilat ushtrojnë shërbime të caktuara me shfrytëzimin e autorizimeve publike, si p.sh: drejtorja doganore, drejtorja e të hyrave publike, MEPSO, ELEM, organet e pavarura rregullatore, si: Agjensioni i komunikimeve elektronike, Drejtorja e fluturimeve civile, Agjencioni i postave etj.

Sa për ilustrim mund ta marrim konkursin e fundit të shpallur vetëm para disa ditëve nga SH.A. MEPSO - Shkup, ku kërkohen nëntë punonjës, në mesin e të cilëve një shef kabineti i cili duhet të ketë arsimim të lartë të mbaruar (240 ECTS) me vetëm dy vite përvojë pune, që do të ketë pagë mujore 45.300 denarë, ose një nëpunës për printimin e dokumentacioneve, i cili me shkollim të mesëm pa përvojë pune do të ketë pagë mujore 24.900 denarë! Këto paga mujore të cilat ofrohen në shembullin e lartshënuar do ua kishin zili nëpunësit administrativ në kuvend, presidencë, qeveri apo ministri.

Prandaj, nivelizimi i pagave duhet të sjell edhe uljen e pagës mujore nëse vlerësohet se është kaluar limiti i lejuar. Jam i mendimit që kjo fushë specifike të rregullohet me ligj të veçantë që do të vlejë për tërë sektorin publik, sepse siç theksuam është fushë e parregulluar sa duhet dhe ka pabarazi të shumta në përcaktimin e rrogave.

Duhet shfrytëzuar ky moment, kur vendi ndodhet në këtë proces të reformimit të administratës publike dhe shtetërore dhe kjo problematikë të merr fund. Së fundi pagat mujore në sektorin publik nuk mund të rregullohen vetëm me vendime të veçanta, por duhet të rregullohen me ligj, ashtu siç e kanë shumica e shteteve të rajonit dhe ato anëtare në BE-së.



Doc.dr. Argëtim SALIU

S'do mend se çështja e pagave mujore në sektorin publik dhe shtetëror është një fushë specifike e cila mbështetet në ligj dhe në akte nënligjore. Por nevoja për nivelizimin dhe standardizimin e pagave në sektorin publik lind për shkak të divergjencave të mëdha që ekzistojnë në pagat mujore. Kemi pabarazi tek nëpunësit të cilët për punë të njëjtë, në sektor të njëjtë, por të punësuar në institucione të ndryshme marrin paga mujore krejtësisht ndryshe!

Veturat e shumta, Korporata Energjetike e Kosovës, përdorimi i thëngjillit për ngrohje, kushtet e pafavorshme atmosferike po konsiderohen nga institucionet e vendit faktorët kryesorë të ndotjes së ajrit në Kosovë

Ndotja e ajrit në Prishtinë ka arritur në nivele alarmante. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë iu ka bërë thirrje qytetarëve që të reduktojnë daljet në qytet dhe në vendet me ajër të ndotur, sidomos në mëngjes dhe mbrëmje. "Qëndroni në shtëpi dhe mos i hapni dritaret për ajrosjen e dhomave. Personat që pashmangshëm duhet të dalin në aktivitetet e tyre jashtë shtëpisë të përdorin maska mbrojtëse ose të mbulojnë gojën e hundën me shall", thuhet në komunikatën për media të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik. Sipas të dhënave të Agjencionit të Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ambasadës Amerikane vlerat e PM 2.5 janë mbi vlerat e lejuara. Në rrugët e Prishtinës janë parë qytetarë të cilët i janë përgjigjur thirrjeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike që të përdorin maska mbrojtëse. Lindita Azemi qytetare, thotë se është mjaft e shqetësuar për nivelin e ndotjes së ajrit në kryeqytet, ku ajo jeton bashkë me familjen e saj. "Ajri i ndotur po shihet edhe me sy, po ashtu edhe kur po nuhatet, ka një aromë të çuditshme. Është për të ardhur keq. Unë mundohem të jetoj shëndetshëm të ushqehem shëndetshëm me aq mundësi sa kemi në Kosovë, ndërkohë kemi ajrin e ndotur që po na helmon", thotë ajo.

Edhe Shqipe Sylejmani e cila jeton në lagjen Kodra e Diellit në Prishtinë flet për nivel të lartë të ndotjes së ajrit, e që sipas saj, po i krijon probleme në shëndet. "Ajri në mëngjes ishte shumë i ndotur dhe në veçanti në mbrëmje po kalon në nivel edhe më të lartë të

"MOS I HAPNI AS DRITARET PËR AJROSJE"



ndotjes. Kjo është një gjendje e rëndë po rrezikohemi nga ajri i ndotur. Institucionet dhe të gjithë ne duhet të bëjmë diçka në përmirësimin e pastërtisë së ajrit", thotë Sylejmani. Abedin Gashi, prindër i dy fëmijëve thotë të jetë më shumë i shqetësuar për së shumti për fëmijët e tij. "Po mendoj që kurrë nuk ka qene ajri më i ndotur se tani. Po shqetësohem shumë për shëndetin e fëmijëve të mi. Nuk di as çfarë masa të ndërmarr. Vërtet keq", thotë Gashi. Përkeqësimi i nivelit të cilësisë së ajrit në Prishtinë, ka vënë në alarm Ministrinë e Mjedisit të Planifikimit Hapësinor dhe dikasteret tjera, të cilët kanë paralajmëruar masa për uljen e nivelit të ndotjes së ajrit.

Qeveria ka miratuar të hënën kërkesën e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për krijimin e Task-forcës të udhëhequr nga kjo ministri dhe ka kërkuar nga të gjithë akterët që të ndërmarrin masat në fushën e tyre të përgjegjëse për të përmirësuar nivelin e pastërtisë së ajrit. Ministria e Mjedisit të Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj ka kërkuar që të merret vendim për ndalimin e përdorimit të thëngjillit dhe lëndëve tjera djegëse - ndotë-

se për ngrohje në shkolla. Derisa, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik është kërkuar që të merret vendimi për ndërprerjen e dhënies së thëngjillit falas për punëtorët e KEK-ut. Ndërkohë, në koordinim me Komunën e Prishtinës është marrë vendim që në periudhat kur nivel i ndotjes së ajrit është i lartë të reduktohet qarkullimi i veturave në disa lagje duke bërë pa pagesë transportin publik. Ekspertët e Institutit Kombëtar paralajmërojnë se nëse nuk merren masa urgjente, do të ketë efekte negative në dëmtimin e shëndetit dhe rritja e vdekshmërisë nga të gjitha shkaqet e sidomos nga sëmundjet kardiovaskulare dhe respiratore do të jetë shqetësuese. Agron Bektashi, ekspert i çështjeve mjedisore në Kosovë, në një prononcim për Radion Evropa e Lirë thotë se situata sa i përket çështjes së ndotjes së ajrit është serioze dhe duhet ndërmarrë masa urgjente. "Situata është mjaft serioze dhe të gjitha këto matje qofshin nga institucionet e shtetit dhe Ambasada Amerikane, tregojnë se ndotja e ajrit në rajonin e Prishtinës është mund të them gati alarmante". "Nuk është një situatë që zgjidhet brenda një dite, një jave apo gjashtë muajve. Kjo

PRISHTINA, QYTETI MË I NDOTUR NË BOTË

Qyteti i Prishtinës ditëve të fundit po përballlet me një masë të lartë të ndotjes së ajrit, gjë që ka shkaktuar alarm edhe tek qytetarët dhe institucionet përkatëse. Sipas matjeve të fundit, kryeqyteti i Kosovës është renditur si vendi më i ndotur në botë. Ajri në qytet po cilësohet si i rrezikshëm për shëndetin, ndërkohë që nuk po zbatohet ndonjë strategji e cila do të ndikonte në përmirësimin e jetës së qytetarëve. Matjet ditore që i bëhen ajrit në Prishtinë, asnjëherë nuk zbresin nën 400 PM.

kërkon një strategji të detajuar dhe një bashkëpunim të ngushtë, që fatkeqësisht ka munguar ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe operatorëve ekonomikë dhe institucioneve relevante shtetërore. Të bëhet një konsensus për çështjen mjedisore, pasi që jemi në një situatë serioze", thotë Bektashi.

Ndotja e ajrit, sipas Bektashit ka ardhur si pasojë e një zhvillimi të pakontrolluar dhe një planifikimi të keq urbanistik dhe hapësinor, si dhe mbipopullimit që është bërë në Prishtinë. "Prishtina për shkak të mbipopullimit të cilën e ka përjetuar gjatë 15 viteve të fundit, ka një hyrje enorme të automjeteve, ku deri në 30 mijë automjete hynë në ditë, dhe në anën tjetër planifikimi i keq hapësinor në këtë vend ka

lejuar të ndërtohet lagje të tëra të cilat ngrohen me sisteme vetanake, që shumica bazohen në thëngjill dhe dru", thotë Bektashi. Veturat e shumta, Korporata Energjetike e Kosovës, përdorimi i thëngjillit për ngrohje, kushtet e pafavorshme atmosferike po konsiderohen nga institucionet e vendit faktorët kryesorë të ndotjes së ajrit në Kosovë.

Në Kosovë llogaritet të jenë afër 385 mijë vetura, ku mesatarja e vjetërsisë së tyre që qarkullojnë në vend është 18 vjet. Për degradimin e mjedisit jetësor, Kosova ishte kritikuar edhe nga mekanizmat ndërkombëtarë. Në raportet e këtyre mekanizmave, Kosova ishte renditur në nivelin më të ulët të standardeve mjedisore në Ballkanin Perëndimor dhe në Evropë. (REL)

12 milionë dokumente të Kosovës mbahen ende në Serbi

Në shtator të vitit të kaluar janë bërë gjashtë vjet që nga aritja e marrëveshjes për kadastër në mes të Kosovës dhe Serbisë. Por kjo marrëveshje ende nuk është zbatuar. Asnjë prej rreth 12 milionë dokumenteve dhe hartave, që sipas kësaj marrëveshjeje ishin paraparë të ktheheshin nga Serbia në Kosovë, nuk ka mbërritur në Agjencinë Kosovare për Kthim dhe Verifikim të Pronave (AKKVP). Deri në qershor të vitit 2016 përgjegjëse për vonesa në zbatim të kësaj marrëveshjeje kanë qenë institucionet e Kosovës, pasi që në bazë të marrëveshjes ishte para-



parë që Kosova të hartonte Ligjin për AKKVP-në. Ndërkohë që nga qershori i vitit 2016 përgjegjëse

për moszbatim të kësaj marrëveshjeje, sipas institucioneve kosovare, është Serbia.

Spanja kundër Kosovës si pjesë e zgjerimit të BE-së

Vetëm një javë para miratimit të Strategjisë së zgjerimit për vendet e Ballkanit Perëndimor, e cila do të miratohet më 6 shkurt në takimin e kolegjit të komisarëve në Strasburg, Spanja ka vënë në pikëpyetje edhe një herë jo vetëm këtë strategji, por tërë procesin, për shkak të kundërshtimeve të ashpra që ka ky shtet ndaj përfshirjes së Kosovës në çfarëdo procesi, që lë përshtypjen se Kosova po trajtohet si shtet. Në një letër, që thuhet se në formën e "non paper" Spanja i ka dërguar Komisionit Evropian në prag të miratimit të Strategjisë së zgjerimit në Ballkanin Perëndimor,

të cilën e ka siguruar "Koha Ditore", Spanja kundërshton përdorimin e termit WB6 (shkurtesë për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor) dhe shprehet se "Kosova nuk është pjesë e procesit të zgjerimit". Nëse merren në konsideratë vërejtjet e Spanjës atëherë në vend të inkurajimit, Strategjia e zgjerimit dhe BE-ja do të shuanin edhe më shumë shpresat për besimin në procesin e zgjerimit të BE-së. Në qarqet diplomatike madje përmendet se Spanja mendon të kundërshtojë edhe pjesëmarrjen e Kosovës në Samitin e Sofjes mes BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor.

RUSIA PA PUTININ!



Në të gjithë Rusinë njerëzit demonstrojnë kundër rizgjedhjes që pritet të Presidentit Vladimir Putin. Kritikun e njohur të Kremlinit, Aleksej Navalni, policia e ka arrestuar sërish

"Qytetare dhe qytetarë, ju lutem hapni rrugën. Po pengoni kalimtarët". Zëri i policit ushton herë pas here nga makina me altoparlant e në Sheshin Pushkin në qendrën e Moskës. Por rreth 2000 pjesëmarrësit e demonstratës së pamiruar, kryesisht të rinj i injorjnë forcat e sigurisë. Ata thërresin parulla si "Rusia do të jetë e lirë" ose "Rusia pa Putinin". Njëri prej tyre e quan veten Vasilij - emrin e vërtetë ai nuk ka dëshirë ta thotë për shkak të raprezaljeve. "Që prej 18 vjetësh gjithmonë i njëjti President - boll", shan ai. Një grua pranë tij e mbështet: "Ne duam një alternativë ndaj pushtetmbajtësve të tanishëm dhe

kërkojmë liri mendimi". I zemëruar është edhe një i ri, i mbështjellë në një pallto të zehtë. "Zgjedhjet e tanishme presidenciale janë një lloj teatri". Një president i fortë nuk do të kishte frikë nga zgjedhjet e reja, thotë një 14 vjeçare, e cila ka ardhur në demonstratë me shoqen e saj. "Dua që në vendin tonë të vepron me ndershmëri dhe në përputhje me ligjin". Ajo thotë se Kremlini u ndalon njerëzve që të votojnë për atë kandidat, për të cilin donin të votojnë shumë njerëz. Me këtë ajo ka parasysh Aleksej Navalnin, i cili në fakt donte të drejtonte demonstratën. Por pak pasi ai u largua nga shtëpia e tij në Moskë, policia e ar-

restoi në një aksion të papritur në rrugë. Kur demonstruesit në rrugë e mësojnë këtë, atë zemërohen edhe më shumë dhe e shajnë Presidentin Putin. Njëri prej tyre është një burrë që e quan kriminel Putinin, i cili e qeveris Rusinë me shokët e tij të Shërbimit të Fshehtë. Njerëzit përreth tij tundin kokën me miratim. Deri sa dikush thërret me zë të lartë: "Zabastovka", gjë që do të thotë pak a shumë "grevë", "protestë", "bojkotim i zgjedhjeve". Demonstruesit vihen sërish në lëvizje. Policia tregohet e përmbajtur. Dyzina ekipesh televizive shoqërojnë vargun e protestave. Të dielën në të gjithë Rusinë pati demonstrata

në mbi 100 qytete ruse, për solidaritet me Navalnin. 41 vjeçari ka bërë thirrje për të bojkotuar zgjedhjet e afërta presidenciale, pasi autoritetet ia ndaluan për shkaqe jotransparente që të kandidojë në zgjedhje. Në një kohë kur në shumicën e vendeve autoritetet kanë lejuar demonstrata, policia i ka ndaluar midis të tjerash në Sankt Petersburg dhe në Moskë protestat publike. Megjithatë, demonstruesit nuk tremben nga dispozita të tilla administrative. Policia bëri të ditur se deri në mbrëmjen e së dielës në të gjithë Rusinë u arrestuan gjithsej 185 demonstrues, duke përfshirë edhe Navalnin vetë.

Irlanda do të mbajë referendum për abortin

Kryeministri i Irlandës, Leo Varadkar, tha se vendi i tij do të mbajë referendum në fund të majit, për të hequr ose jo ndalesën kushtetuese mbi shumicën e aborteve. Qeveria e ka marrë vendimin të hënën vonë. Varadkar tha se votuesit do të pyeten nëse duan ta mbajnë në fuqi amendamentin e tetë të Kushtetutës, apo ta shfuqizojnë atë dhe të autorizojnë Parlamentin të krijojë legjislacionin për abortin. Irlanda, kryesisht e krishterë, ka ndalesën më të rreptë të abortit në Evropë. Aborti atje është i ligjshëm vetëm në rastet kur jeta e nënës është në rrezik. Varadkar, i cili kryeson partinë e qendrës së djathtë Fine Gael, ka bërë fushatë për të lehtësuar ndalimin e abortit.

Policia në kërkim të hajdutëve që vodhën 44 ton çokollatë

Policia gjermane është vënë në ndjekje të hajdutëve të cilët vodhën 44 ton çokollatë në jug të vendit të premtën e kaluar. Policia të hënën njoftoi se dy kamionë me çokollata janë vjedhur në një park industrial në Freiberg. Vlera e çokollatës vlerësohet në 400 mijë euro.

Një kamion me rimorkio me targa polake u gjet të shtunën pranë kufirit gjermano-francez. Shoferi u arratis në këmbë kurse rimorkio mbeti me ngarkesën e sasisë të madhe të çokollatës. Kamioni tjetër u gjet në qytetin Lahr, gjithashtu pranë kufirit me Francën. Dy të tretat e çokollatës janë ndërsa hajduti është arratisur. Policia është vënë në kërkim të hajdutëve dhe u bëri thirrje qytetarëve që të raportojnë nëse posedojnë çfarëdo informacioni.

Indi, 21 milionë vajza "të padëshiruara"



Dëshira e prindërve në Indi për të pasur djem, ka krijuar 21 milionë vajza të "padëshiruara", vlerëson një raport i qeverisë vendase. Raporti i Ministrisë së Financave ka gjetur shumë çifte që kanë sjellë në jetë fëmijë, deri sa kanë lindur një djalë. Autorët e quajtën këtë një lloj delikatese të preferencës së djalit, krahasuar me abortet selektive të seksit, por paralajmëruan se kjo mund të çojë në më pak vajza në shoqëri. "Preferenca e djalit është

një çështje për të reflektuar, për shoqërinë indiane", u shprehën autoritetet vendase. Autorët zbuluan gjithashtu se 63 milionë gra ishin "të zhdukur" nga popullsia e Indisë, sepse preferenca për djem të çoi në abortet selektive të seksit dhe më shumë kujdes i ishte dhënë djemve. Testet për të përcaktuar seksin e fetusit janë të paligjshme në Indi, por ato ende ndodhin dhe mund të çojnë në aborte të përzgjedhura nga seksi.

Pentagoni s'ka informacione për vrasjen e civilëve në Afrin

Zëdhënësi i Pentagonit Majori Rob Manning deklaroi se zyrtarët e SHBA-së janë në kontakt me autoritetet turke mbi operacionin ushtarak në Afrin. Manning tha se SHBA-të nuk kanë informacion në lidhje me akuzat për "humbje të civilëve" në Afrin. Duke iu përgjigjur

pyetjes së gazetarit në lidhje me akuzat se në operacionin "Dega e Ulliri" të nisur nga Turqia në veriperëndim të Sirisë, me qëllim të neutralizimit të elementeve terroriste në Afrin, ka patur edhe humbje të civilëve, Manning tha se ai nuk ka asnjë informacion lidhur

me këto pohime. "Ne vazhdojmë të bashkëpunojmë me aleatin tonë të NATO-s, Turqinë në rajonin Afrin. Nuk kam informacione në lidhje me zhvillimet për të cilat flisni", ka thënë Manning. Duke folur për trupat amerikane në Munbixh të Sirisë, ai tha se SHBA dhe Turqia ishin

në kontakt me sigurinë e trupave në zonë. Ai e karakterizoi komunikimin midis Turqisë dhe SHBA-ve në lidhje me këtë të afërt dhe konstant, kurse në pyetjen nëse forcat amerikane në Munbixh janë të pranishme si një forcë mbrojtëse në rast të një sulmi, ai u përgjigj

negativisht. Manning tha se Turqia është e njoftuar me vendndodhjet e trupave amerikane në Munbixh dhe shtoi se forcat amerikane në rajon ndodhen për shkak të komunikimit me forcat e mbrojtjes të Munbixhit që janë përgjegjës për mbrojtjen e qytetit nga DEASH-i.

GJERMANIA DHE FRANCA PËR MARRËVESHJE TË RE

KUSH DO TA DREJTOJË EVROPËN?



55 vjet pas Marrëveshjes së Elysee-së Gjermania e Franca kërkojnë një marrëveshje të re. Me ardhjen e Macronit diskutohet edhe drejtimi politik i Evropës

"Çfarë njerëzish" citohet të ketë thënë Presidenti francez Charles de Gaulle për gjermanët, duke parë menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore në Stalingrad përmasat e shkatërrimeve të nazistëve. Dhe ishte pikërisht Charles de Gaulle që i njihte mirë fqinjët gjermanët, pasi kish kaluar mbi dy vjet (1916-1918) edhe si rob lufte i tyre, më se i ndërgjegjshëm për gjurmët e thella të armiqësisë shekullore mes Francës dhe Gjermanisë, që do të mernte iniciativën për pajtimin e madh me Gjermaninë. Me Evropën në gërmadhat e Luftës së Dytë Botërore para syve, që në shtator 1946 britaniku Winston Churchill pati kërkuar që „hapi i parë për rindërtimin e familjes evropiane duhet të jetë partneriteti midis Francës dhe Gjermanisë“.

MIDIS VIZIONEVE LARGPAMËSE DHE INTERESAVE TË PADEKLARUARA NACIONALE

Por siç e përshkruan historiani dhe politologu i njohur francez Alfred Grosser me rëndësi "thelbësore" për rindërtimin e Evropës ishte që de Gaulle aprovoi pas Luftës atë që kishte kundërshtuar më parë si opozitar: ndërtimin e një Evrope të përbashkët dhe "rëndësinë parimore të marrëdhënieve gjermano-franceze". Ndërtimi i një të ardhmeje pa konfliktin e vjetër me fqinjin gjerman në shpirtat evropianë të dërrmuar nga shkatërrimet e luftës së fundit botërore, në Francë, por edhe në Gjermani. Vizita e de Gaulle-t në Bonn në shtator 1962, fjalët e tij në gjermanisht nga ballkoni i bashkisë së Bonnit, se ai ushqente "vlerësim të thellë për popullin e madh gjerman, për Gjermaninë e madhe" zgjuan entuziazëm për kohë të reja, në Gjermani dhe gradualisht më gjerësisht edhe

në Francë. Në këtë frymë, shpejt pas kthimit të de Gaulle-t në atdhe përfundoi hartimi i një traktati, i një "marrëveshjeje miqësie" midis Francës dhe Gjermanisë. Ajo u nënshkrua në 22 janar 1963 në Pallatin Elysee.

Miqësia personale që lidhi prej takimit të parë presidentin vizionar francez Charles de Gaulle dhe kancelarin fjalëpak gjerman, Konrad Adenauer shërbeu që mosmarrëveshjet dhe motivet e padeklaruara të mos pengonin pajtimin e madh mes kombeve. Një nga synimet e de Gaulle-it, siç pohohet nga shumë historianë, ishte që ta shfrytëzonte një Evropë të fortë dhe të bashkuar për të forcuar pozicionin e Grande Nation, të vendit të tij në botë, të dobësuar edhe nga luftërat në kolonitë franceze. Me këtë mendësi kundërshtoi ai më vonë edhe pranimin e Britanisë së Madhe në Komunitetin Evropian. Kurse Gjermania Perëndimore ishte e interesuar të bëhej pjesë e bashkësisë së civilizuar të kombeve evropiane, që ishte tepër skeptike ndaj saj, për shkak të barbarive naziste në Evropë. Nën presionin e një agresioni sovjetik ndaj Evropës, Gjermanisë i qe lejuar vetëm pesë vjet pas Luftës së Dytë Botërore të riarmatosej. Por sovraniteti gjerman administrohej krejtësisht nga fuqitë pushtuese. Pas Luftës së Dytë Botërore dhe përvojave me nazizmin, Gjermania Perëndimore u ngjiz që në krye, u konceptua nga amerikanët me një antipati ndaj çdo modeli centrist - të favorizuar nga Franca. Ky është një nga shpjegimet pse në ratifikimin e Marrëveshjes së Elysee-së, Bundestagu i shtoi Marrëveshjes një preambulë, ku dilte në pah mbështetja e një mendësie multilateraliste: në preambulë theksohej vullneti

për forcimin e NATO-s dhe shpresa për një anëtarësim të Britanisë së Madhe në Komunitetin Evropian. Deri ku ushqeheshin nga një besim i vërtetë tek miqësia dhe ku ushqeheshin thjesht nga pragmatizmi, vizionet e pasluftës për marrëdhëniet midis dy shteteve më të fuqishme të Evropës, kjo sot është e vështirë të përcaktohet, por edhe ka pak rëndësi. Shumë vite më vonë, në një kontekst tjetër, de Gaulle do të thoshte se në jetën e tij ai kishte bërë shumë herë "sikur" dhe shumicën e herëve kishte funksionuar.

NË THEMEL TË PAJTIMIT: MARRËVESHJA E ELYSEE-SË

Sidoqoftë, marrëveshja e Elysee-së i hapi rrugë një dinamike shkëmbimesh dypalëshe, që rezultoi me rëndësi vendimtare për pajtimin e dy kombeve. Themelimi në këtë kuadër i Zyrës Gjermano-Franceze të Rinisë bëri që brezat e rinj në Francë e Gjermani të njohin gjerësisht, në kontakte të drejtpërdrejta njëri-tjetrin. Të rinjtë punojnë me sukses në përmasa të gjera dhe jo formalisht për rrëzimin e paragykimëve. Politikisht, takimet e nivelit të lartë deri në mbledhje të përbashkëta të kabineteve qeveritare në Paris dhe në Berlin janë kthyer në normalitet. Sot konsiderohet e vetëkuptueshme që ministrat e dy vendeve të takohen rregullisht, siç e përcakton kjo marrëveshje e vitit 1963. Një veprim normal është që në takime të tilla ata të propagandojnë pikëpamjet vetjake e të gjejnë kompromise.

Edhe pakënaqësitë reciproke në to diskutohen më lehtë: gjermanët ankohen për pengesat burokratike, për masat proteksioniste me të cilat Franca izolon tregun e saj ndaj botës; francezët shprehin habi për frikën gjermane,

se francezët duan ta zhvillojnë Evropën me para gjermane, duke kërkuar që gjermanët ta financojnë këtë zhvillim. Marrëveshja e Elysee-së është një model suksesi, të cilit sot i referohen në Evropë. Iniciimi nga Berlini më 2014 i atij që njihet si "Procesi i Berlinit", që synon ndër të tjera afrimin e bashkëpunimit mes shteteve të Ballkanit, orientohet shprehimisht te pajtimi historik i Gjermanisë me Francën.

55 VJET MË VONË KËRKOHEM NJË MARRËVESHJE E RE BILATERALE

55 vjet pas Marrëveshjes së Elizesë në Berlin dhe në Paris nuk shohin alternativë tjetër veç thellimit të bashkëpunimit. Fryma antigjermane e pranishme te shumë socialistë francezë, jo më larg se katër vjet më parë, kur ata shpallnin fajtores Gjermaninë për lëngimin e ekonomisë franceze, për shkak të koncepteve ekonomike gjermane të kursimit në Evropë, sot duket e harruar. Në 22 janar 2018 paradite, në Berlin foli para Bundestagut Presidenti i parlamentit francez, François de Rugy. Pasdite për thellimin e miqësisë foli në Paris, Presidenti i Bundestagut gjerman, Wolfgang Schäuble. Në përkujtimit të 55 vjetorit të marrëveshjes mes Konrad Adenauerit dhe Charle de Gaulle-it shkoi në Paris edhe kancelarja Angela Merkel. Në këtë kuadër është përsëritur edhe nevoja për zgjerimin apo për një marrëveshje të re midis Gjermanisë e Francës. Kjo ka kohë që kërkohet, por qeveria aktuale franceze, shumë ministra të së cilës janë njohës të mirë të gjermanishtes dhe Gjermanisë, duket se do ta mbështesë seriozisht këtë hap. Për një marrëveshje të re mes Gjermanisë dhe Francës ka disa arsye: zhvillimi i mëtejshëm i Eurozonës, si dhe sistemi evropian i

mbrojtjes duan përgjigje të reja. Për to dy shtetet drejtuese të Bashkimit Evropian mund të pajtohen më lehtë se një tërësi 27 shtetesh të BE. Si utopi u duket disa analistëve në Gjermani plani që marrëveshja e re bilaterale të hapë rrugën edhe për një legjislacion të përbashkët për tatimet. Gjermania dhe Franca duan të përafrojnë kuotat e tatimit të sipërmarrjeve në të dyja vendet. Sidoqoftë: BE ka nisur dhe gjithmonë është zhvilluar përmes bashkëpunimit Gjermani-Francë.

EMMANUEL MACRONI - LIDERI I EVROPËS SË ARDHSHME?

Kancelarja Merkel tha në Davos të Zvicrës se me zgjedhjen e Macronit në Francë në Bashkimin Evropian ka ardhur një vull i ri. Dhe padyshim, me Emmanuel Macronin Gjermania ka tani në Francë një partner në të njëjtin nivel me veten. Macroni njëkohësisht ka treguar me veprimet e tij që prej zgjedhjes President se është i ndërgjegjshëm që Evropa nuk drejtohet dot pa Gjermaninë. Kaq i ndërgjegjshëm është për këtë sa fjalimin, që mbajti vjet në fund të shtatorit në Sorbonë me vizione për Evropën, Macroni ia nisi paraprakisht që ta lexonte kancelares Merkel. Dhe bëri më pas disa modifikime me dëshirën e saj. Këtë ai e tregoi vetë në një intervistë me mediat gjermane. Njëkohësisht Macroni nuk harron të kujtojë se Franca është e vetmja fuqi atomike e Evropës kontinentale. Dhe anëtarë e përhershme e Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Por Gjermania është ekonomia më e madhe dhe më e fuqishme e BE. Dhe ngjizja e Evropës së re, krijimi i Komunitetit Evropian nisi me ekonominë, me krijimin e komunitetit të Çelikut dhe Qymyrit mes Francës e Gjermanisë. Macroni ka ritheksuar se BE është një projekt politik, duke aluduar për rolin drejtues të Francës në konfigurimin politik të Evropës pas Luftës së Dytë Botërore. Njëkohësisht, roli politik i Gjermanisë është forcuar gjatë krizës së eurozonës dhe krizave të fundit në botë. Dhe në vitet e gjata të dobësisë së Francës. Se kush do ta drejtojë Evropën në të ardhmen, kjo mbetet të shihet. Ndoshta një kombinim i aftësive, i vizioneve të Presidentit Macron dhe i pragmatizmit të Kancelares Merkel mund të jetë një zgjidhje e mirë për Evropën.

PËRFUNDON GJITHÇKA, MUSLIU ZYRTARISHT TE SHKËNDIJA

Mbrojtësi reprezentues më në fund vjen në vendin e duhur. Pasi në të kaluarën gjithmonë dilte ndonjë pengesë që pamundësonte transferimin, kësaj radhe Shkëndija bën të vetin Visar Musliun



Shkup, 30 janar - Pas Bilallit, Adilit, Mustafit, Sadriut dhe Vakilit, Musliu është futbollisti i gjashtë që bashkohet me Shkëndijën në këtë afat kalimtar, me çka mbyllet merkatoja e kuqezinjve për gjysmësezonin pranveror ku kërkohet

titulli i kampionit. Mbrojtësi qendror vjen te Shkëndija në formë huazimi nga radhët e FC Prishtinës, me opsion për blerje të kartonit të plotë të lojtarit në fund të sezonit aktual. 23 vjeçari i dalë nga

shkolla e futbollit Gostivari, përmes Renovës nga një sezon ishte pjesë e Sent Galenit të Zvicrës dhe Vardarit të Shkupit. Paraqitjet bindëse e kanë bërë pjesë e gjithë përfaqësuesve të reja të Maqedo-

nisë, me U21 ishte pjesë e suksesit historik dhe pjesëmarrjes në Kampionatin Evropian për të rinj në Poloni, ndërsa u konfirmua standard në përfaqësuesen A në fund të eliminatorëve për Botërorin "Rusi

2018". Ndërkohë, KF Shkëndija ka zyrtarizuar të hënën pasdite marrëveshjen me mbrojtësin nigerian Alma Abbo Vakili. 21 vjeçari vjen nga Trakai i Lituanisë dhe pritet të përforcojë krahun e majtë të mbrojtjes. Futbollisti nga Nigeria la përshtypje pozitive në dy përballjet Shkëndija-Trakai në turin e tretë eliminator të Liga Evropës, pas së cilës gjithë këtë periudhë ishte nën monitorim të stafit teknik. Edhe pse në moshë të re, ai vlerësohet mbrojtësi i majtë më i mirë në kampionatin lituanes, me një shpejtësi admiruese, ndërsa në Evropë ka zbankuar përmes AS Eupen të Belgjikës. Kështu kuqezinjët mbyllën me sukses negociatat me futbollistin dhe Trakain, duke e sjellë zyrtarisht atë në Tetovë. Ndërkohë, shkaku i vizës nigeriane nuk do të mund të bashkohet me skuadrën në fazën përgatitore në Antalia të Turqisë dhe këtë periudhë do të stërvitet me ekipin e juniorëve kuqezi në Tetovë.

Zubairov, përforcimi i radhës i KM "Liria"

Shkup, 30 janar - Klubi i mundjes "Liria" ka arritur që për një kohë të shkurtë të përforcohet me dy mundës cilësor. Pas Stole Eftimovit, i cili erdh nga klubi i mundjes "Spartak", klubi më i suksesshëm shqiptar ka zyrtarizuar edhe goditjen e dytë. Fjala është për Halil Zubairovin, ish-kampionin evropian për kadet dhe fitues i medaljes së bronzit nga Kampionati Evropian deri 23 vjeç. Zubairov është prezantuar me fanellën e klubit nën shoqërinë e nënkryetarit Ame Ademi. Ndryshe, transferimi i Zubairov te KM "Liria" konsiderohet si një prej transferimeve më të bujshme në historinë e mundjes së Maqedonisë. (B.K.)



Basilio Ndong përforcon Shkupin



Shkup, 30 janar - Skuadrës së Shkupit në përgatitjet në Antalia nga dita e djeshme i është bashkuar edhe një futbollist i ri, bëhet fjalë për 19 vjeçarin Basilio Ndong Ovono Nçama i cili vjen nga shte-

ti i Guineja Ekuatoriale, ndërsa ishte pjesë e skuadrës "Cano Sport Academy". Gjatë kohës së fundit, skauti i FC Shkupi Bulent Akin (Ish-futbollist i Gallatasarajit, fitues i UEFA Kupës), i cili po qën-

dron në Afrikë dhe ka përcjellë ndeshjet e Kupën e Afrikës, ka arritur të shënjestrojë pikërisht Basilion, i cili me paraqitjet e tija të mira për reprezentacione Guinejas Ekuatoriale ndaj Nigerisë dhe Rundës, kanë arritur që ta bëjnë të veshë fanellën bardhë e kaltër. Ndryshe, kalimi i Ndong Shkupit i ka kushtuar 60 mijë euro dhe prezenca e tij në skuadër do të jetë e dobishme si për ekipin, por edhe për futbollin në Maqedoni. Futbollisti 19 vjeçar nga Afrika luan në pozitën e sulmuesit të krahut të majtë, i cili në stërvitjen e parë të skuadrës ishte i mirëpritur nga stafi dhe futbollistët dhe pritet që shumë shpejt të adaptohet në ekip. Kontrata e Basilio me Shkupin është nënshkruar për tre vite e gjysmë.

Asani vazhdon karrierën në Uzbekistan

Shkup, 30 janar - Xhelil Asani kalon te skuadra e Mash'al Mubarek në Uzbekistan bën të ditur "Vipsport.al". Sipas tyre ish-lojtari i Bylisit që gjatë pjesës së parë të sezonit ishte te Shkëndija e Tetovës, ka arritur akordin final me skuadrën në FC Mash'al. Mbrojtësi që luan edhe si mesfushor krahu, gjatë merkatos së verës ishte në planet e Flamurtarit, por ai zgjodhi të transferohej te kuqezinjët. Gjatë kësaj merkatoje dimri, Asani është ndarë me mirëkuptim nga klubi tetovar dhe do të vijojë karrierën e tij në Uzbekistan. Ka qënë një ofertë e "majme" që ka joshur Asanin për të kaluar te FC Mash'al, ndërsa marrëveshja është arritur falë menaxherit Luan Kadriu. 22-vjeçari u bë i njohur tre sezone më parë kur ishte pjesë e Bylisit, ku në një moshë shumë të re arriti të bënte paraqitje shumë pozitive në Superligë.



BEKAM DËSHIRON QË IBRA TË RRIJË TE MANÇESTER JUNAJTEDI



AI ËSHTË NJË "BISHË"

Duke folur në ngjarjen e së hënës, që konfirmoi ekskluzivitetin e tij në Majami, si ekipi i ardhshëm i MLS, Bekam tha se nuk është i gatshëm ta shohë ish-shokun e tij të PSZH-së të bëjë kalimin në "Southern California", ende

Dejvid Bekam dëshiron që Zlatan Ibrahimoviç të qëndrojë te Mançester Junajted mes interesit të raportuar nga LA Galaksi. ESPN raportoi të dielën se sulmuesi suedez po mbyll një marrëveshje për t'u bashkuar me pesë herë kampionët e MLS, ndërsa trajneri i "djajve të kuq", Hoze Murinjo, ka shpjeguar të hënën se ai nuk do ta pengonte një lëvizje të tillë të mundshme. Duke folur në ngjarjen e së hënës, që konfirmoi ekskluzivitetin e tij në Majami, si

ekipi i ardhshëm i MLS, Bekam tha se nuk është i gatshëm ta shohë ish-shokun e tij të PSZH-së të bëjë kalimin në "Southern California", ende. "Pa marrë parasysh se si flisni për të, ai është një nga lojtarët më të mirë, një nga njerëzit më të mirë dhe nëse vjen në këtë ligë në një moment, do të ishte vërtet mirë", - tha Bekam për "ESPN". "Por, për momentin, ai është një lojtar i Mançesterit dhe unë jam i lumtur për këtë. Dua që ai të qëndrojë atje, por në një moment tjetër



mund të vijë këtu". Bekam luajti për Mançesterin nga viti 1992 deri më 2003 dhe Galaksi nga viti 2007 deri më 2012, çka i jep ish-kapitenit të Anglisë një pasqyrë unike në procesin e vendimmarrjes së Ibrahimoviç. Ndërsa disa kritikë besojnë se Ibrahimoviç do të shkonte në MLS shumë vonë, me 36-vjeçarin të kufizuar në një fillim të Premier Ligës këtë sezon, pas rimëkëmbjes nga operacioni i

gjurit, Bekam është më optimist. "Çdo përmendje e ndonjë lojtari të shkëlqyer si Zlatan, që vjen në këtë ligë, mund të jetë e mirë për ligën, -shtoi ai. -Dhe kur flisni për Zlatan, po, është mirë që po flitet kështu, sepse ai do të ishte më shumë se i mirëpritur në këtë ligë nga tifozët, nga lojtarët. Nuk ka rëndësi se çfarë lëndimesh ka pasur gjatë karrierës së tij, ai është një bishë".



Deulofeu përfundon te Uatfordi

Deri pak ditë më parë ishte i sigurt rikthimi i Xherard Deulofeu në Serinë A. Por dje, gjërat kanë marrë një tjetër rrjedhë, sepse sulmuesi i Barcelonës ka shkuar të luaj në Premier Ligë. Sipas shtypit katalanas, Deulofeu ka arritur marrëveshjen për t'u transferuar te Watford. Pas largimit nga Milani, sulmuesi spanjoll u rikthye te Barcelona në verë, por në pjesën e parë të sezonit nuk gjeti shumë hapësira. Tashmë me ardhjen e Kuntinjos, minutazhi për të do të jetë shumë i ulët. Interi, Roma dhe Napoli kanë shprehur interes për Deulofeu, por tashmë është trajneri i Watfordit, Havi Grasia që ka bindur sulmuesin spanjoll të zgjedhë Premier Ligë. Kujtojmë se Deulofeu ka qenë edhe më herët pjesë e kampionatit anglez, ku ka luajtur për Evertonin. Tashmë ai është drejt huazimit nga Barcelona te skuadra e Watford.

HULIO CESAR BËHET PISHMAN Firmos për tre muaj në Brazil

I rikthehet fushës portieri brazilian Hulio Cesar, i cili i kishte dhënë lamtumirën futbollit të luajtur, kur mbylli gjithçka me Benfikën në Portugali. Flamengo, klubi ku ka nisur karrierën e tij futbollistike, ka bërë të ditur zyrtarisht se portieri do të kthehet të luajë për të, por vetëm për tre muaj. Portieri brazilian ka vendosur të mbrojë kuadratin e klubit ku ka lindur, ndaj dhe ka nënshkruar për tre muaj me një pagesë simbolike. Njoftimi zyrtar është dhënë nga klubi brazilian në faqen e tij në "Twitter".



Çellsit refuzon 220 mln euro të Sitit për Hazard



E ardhmja e Eden Hazard tani për tani do të mbetet e bashkuar me Çellsin. Mesfushori belg është në orbitën e disa ekipeve evropiane të nivelit më të lartë. Një nga ato që kanë treguar interesin më të madh për të është Mançester Siti. Pas operacionit të Aleksis Sanchez nga Mançester Junajtedi, objektivi kryesor për "qytetarët" është Hazard. Kjo është arsyeja pse ata kanë bërë një ofertë të shkëlqyeshme për Çellsin, prej 220 milionë euro, sipas "Telegraph". Përgjigja e Çellsit ka qenë "jo", e thjeshtë. Klubi i Londrës nuk dëshiron ta pranojë këtë operacion për asgjë në botë, pasi kjo

do të nënkuptonte forcimin e një prej rivalëve kryesorë të tij në Premier Ligës. Megjithatë, klubi nga Londra e sheh të vështirë ndalimin e largimit të Hazard për te Real Madridi. Klubi i bardhë është shumë i interesuar për yllin belg, përmes të cilit do t'i japë një pamje të re skuadër për sezonin e ardhshëm. Ndërkohë, Çellsin po përpiqet ta lidhë Hazard me një përmirësim të kontratës. Blutë e Londrës janë gati t'i paguajnë më shumë se 340.000 euro në javë dhe ta lidhnin me "Stamford Bridge" deri në vitin 2020. Megjithatë, rinovimi nuk ka mbërritur ende...

GATUSO MË MERITORI PËR RINGRITJEN E MILANIT



Për Gattusson kjo ishte hera e parë që do të drejtonte një skuadër të madhe. I lidhur ngushtësisht me ngjyrat e fanellës së Milanit, i vetëdijshëm për përgjegjësinë e madhe që do të kishte mbi supet, tekniku u shfaq i bindur se do të arrijë të ringrejë kuqezinjtë

Xhenaro Gattuso ringjall Milanin. Gjithçka nisi me merkaton, aty ku kuqezinjtë shpenzuan më shumë se 200 milionë euro. Shpresat për një sezon ndryshe ishin të mëdha. Aventura në "Europa League" nisi shkëlqyeshëm, kampionati po ashtu. Deri në momentin, kur rezultatet pozitive filluan të mungonin dhe katër vendet e para filluan të largoheshin. Moment ky që u pasua me largimin e Vincenzo Montellës nga stoli i djallit. Njësoj si para dy sezonesh, stoli iu besua një ishi, Xhenaro Gattusos, i cili më herët kishte

drejtuar skuadrën e Pisas dhe të rinjtë e Milanit. Për Gattusson kjo ishte hera e parë që do të drejtonte një skuadër të madhe. I lidhur ngushtësisht me ngjyrat e fanellës së Milanit, i vetëdijshëm për përgjegjësinë e madhe që do të kishte mbi supet, tekniku u shfaq i bindur se do të arrijë të ringrejë kuqezinjtë. Aventura nisi jo mirë, barazimi ndaj Beneventos i tronditi të gjithë, akoma dhe më e rëndë humbja në Verona 3-0. Gjatë kur luante futboll, Gattuso shquhej për grintën e tij dhe sakrificat në fushën e blertë, tipare

këto që po kërkon t'ia përcjellë skuadrës që ai drejton. Kthesa e madhe nisi në takimin ndaj Interit në Kupën e Italisë dhe fill pas atij momenti, kuqezinjtë nuk kanë humbur asnjë prej katër ndeshjeve të fundit në kampionat. Vetë, tekniku e pranon që kuqezinjtë nuk janë një skuadër e bukur për t'u parë teksa luajmë, por atij i intereson vetëm të fitojë dhe Milani, po e bën një gjë të tillë. Nuk mund të flitet ende me siguri për të ardhmen, por Xhenaro Gattuso ka arritur t'i përcjellë futbollistëve të tij shpirtin luftarak dhe grintën.



Pa gabimet e VAR-it do ishim të parët

Presidenti i Lacios, Klaudio Lotito pati një përplasje mjaft të ashpër me MarSello Niçin, shefin e shoqatës së arbitrave në Itali. I zhgënjyer nga gabimet e arbitrave, edhe pse kanë ndihmën e VAR-it, presidenti i Lacios nuk e ka mbajtur zemërimin ndaj Niçit. "Më shpjego VAR-in! Pa gabimet e arbitrave, tani Lacio do të ishte në vendin e parë", iu hakërrye Lotito, Niçit, ndërsa ky i fundit reagoi duke thënë se VAR po funksionon, por kjo nuk i përjashton gabimet. Lacio është penalizuar shpesh këtë sezon, veçanërisht në ndeshjen me Fiorentinën, kur arbitri akordoi në shtesë një penallti inekzistente për "violët", që solli edhe barazimin, por edhe në humbjen në derbi me Romën. Rasti më i fundit i penalizimit të lacialëve ishte në sfidën ndaj Milanit, kur Kutrone shënoi golin e avantazhit, pas një devijimi me dorë, që i shpëtoi jo vetëm kryesorit, por edhe VAR-it.

20 garues mes tyre katër shqiptar në Soçi

Shkup, 30 janar - Përfaqësuesja e Maqedonisë në Karate do të marr pjesë në Kampionatin Evropian për kadet, Juniorë dhe U21 që do të mbahet në Soçi të Rusisë nga data 02-04 shkurt 2018. Përfaqësuesja e Maqedonisë do të paraqitet me 20 garues në kategori të ndryshme (femra dhe meshkuj), kata dhe kumite (luftëra) në mesin e tyre edhe Doan Osmani U21 -75 kg (KK "Fati" Tetovë), Ardit Marku U21 - 60 kg (KK "Uraniku" Dibër), Krenar Xhaferi junior +76 kg (KK "Shkëndija Tetovë) dhe Fahik Vejse- li junior -61 kg (KK "Olimpik" Shkup). Favoriti nga shqiptarët është Doan Osmani, kampion aktual ballkanik në kategorinë -75 kg në Mal të Zi që u zhvilluan në dhjetor

t vitit 2017. "Jam i kënaqur me formën e tyre fizike dhe tekniko-taktike të garuesve të mi pasi që në stërvitjet e fundit që i zhvilluam në Shkup me reprezentacionin, pash një formë goxha të bukur të 8-garuesve në kategorinë e juniorëve të vjetër 18-21 vjet. Favorit janë të gjithë dhe të gjithë janë në formën e duhur për të bërë rezultate kulminante. Pres një karakter të fort, pa nënçmuar as veten dhe as kundërshtarin, derisa mbrojtjen apo rezultatin pozitiv do ta ruajmë me sulm për të qen më bindës të çdo rrethi. Në Soçi askush nuk do ta ketë të lehtë kur do përballet me garuesit e Maqedonisë", deklaroi seleksionuesi i Maqedonisë në U21 Arlind Huseini



BUFFON NUK DORËZOHET Dua të luaj përsëri, ndoshta edhe dy sezone

Një fundjavë plot surpriza në Seria A, e cila u përshkua nga jubileu i Gjanluigji Buffon, që festoi 40-vjetorin, duke marrë mesazhe urimi nga shumë yje të futbollit evropian dhe ish-shokët. Pas darkës së organizuar për të festuar me partneren dhe familjen e tij, portieri i Juventusit ka zbuluar ndjenjat personale në lidhje me të ardhmen, siç është raportuar nga "Tuttosport": "Ndjehem mirë për të luajtur një sezon më shumë, ndoshta edhe dy. Dua të më shihni në fushë përsëri, sezonin e ardhshëm". Mesazhi për klubin bardhezi është i qartë. Kontrata e legjendës së Juventusit skadon në qershor të vitit 2018, por porta e "Zonjës së Vjetër" tashmë është dorëzuar në duart e trashëgimtarit Shçesny. Tani mbetet për të kuptuar nëse klubi do të jetë i gatshëm të ofrojë një kontratë të re dhe nëse kapiteni do të pranojë një rol të marginalizuar, ndërsa vazhdon ende ndjekjen e ëndrrës së Ligës së Kampionëve, e cila deri më sot mungon në "palmaresin" e portierit.



Bolt në dilema

Pasi është përfolur për një kohë të gjatë kalimi i atletit të njohur drejt një sporti tjetër, Usain Bolt tashmë mund të quhet një futbollist profesionist. Për të parën ka shumë siguri, ndërsa për të dytën ende jo. Kjo pasi edhe pse ka dalë në stërvitjen e parë me skuadrën e Mamelodi Sundons, që luan në Afrikën e Jugut, roli i futbollistit nuk është ende i përcaktuar. Trajneri i ekipit afrikan është shprehur se ia ka lënë në dorë zgjedhje vetë futbollistit. Usain Bolt ka fituar 8 herë medaljen olimpikë në atletikë, por këtë herë ka tentuar të provojë një aventurë ndryshe nga ajo e mëparshme. Nuk është Dortmundi dhe Manchester Junajted siç është përfolur përpara shumë kohësh, Bolt nënshkruan për Mamelodi Sundons.



DASHI 21. mars - 20. prill

Hëna e shfrenuar dhe Urani nuk janë më të mirët për shenjë tuaj dhe sot ju do përjetoni shumë konfuzion. Mos hezitoni të bisedoni me një mik apo partnerin/en për një zgjedhje të mundshme. Beqarët do të duhet të përpiqen të jenë më pak të pavendosur dhe me shumë gjasa do të marrin hapin e parë. Një ndryshim, edhe pse jo i lehtë, do të duhet të trajtohet me vendosmëri në punë.



DEMI 21. prill - 21. maj

Hëna në gaforre ju ndihmon të vendosni gjërat në rregull. Duke u përballur me çdo gjë dhe me të gjithë me mençuri, sidomos duke dëgjuar ato që doni, do të jeni të orientuar drejt së mirës. Beqarët do të duhet të organizojnë veten në mënyrë efikase për të bërë çdo qëllim të mundshëm. Pengesat që do të gjeni në punë nëse nuk menaxhohen siç duhet sot do të ndikojnë në disponimin tuaj.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

E marta do të jetë e qetë për jetën e atyre që janë në çift. Disa gje të vogla do ta bëjnë atë një ditë të ëmbël dhe relaksuese për të dy partnerët. Zemrat e vetmuara do të bëjnë mirë të dëgjojnë këshillat e një miku rreth një personi përpara se të marrin vendime. Filloni të merrni një konfirmim, angazhimi juaj do të shpërblehet në qoftë se ju nuk shkëputeni nga qëllimi i caktuar tashmë.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Mërkuri, Urani dhe Plutoni ju bëjnë nervozë dhe ju largojnë nga qëllimet tuaja, duke ju përfshirë në një shqetësim. Mbështetjen do e gjeni te Jupiteri i cili do ta mbajë të fortë marrëdhënien tuaj në çift! Kënaqësi e madhe për beqarët, sot ju do të bëni njohje të reja dhe interesante. Një investim ose një marrëveshje që nuk të bindin duhet të mbyllet menjëherë.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Sot do të ndjeni nevojën e fortë për të bërë një llogari të marrëdhënies suaj në çift dhe për të analizuar më mirë jetën tuaj private. Nëse diçka është e gabuar dhe nuk ju kënaq, shikoni brenda për të gjetur se çfarë po kërkon. Një ditë rutinë për Luanët beqarë, pak mundësi për të gjetur dashurinë. Opozita e planetëve sot nuk jep shumë mundësi.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Ju keni në favorin tuaj një hënë që tërheq dhe bashkë me Jupiterin ju fut me të gjithë butësinë dhe sensin e përbashkët që nevojitet për të rivendosur paqen dhe për të promovuar mirëkuptimin familjar. Sot, disa kritika të papritura mund të lëndojnë disa beqarë, por mos e mbyllni veten, gjithçka është kalimtare. Entuziazmi dhe vetëbesimi, do të bëjnë që të vazhdoni drejt projekteve ambicioze.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Lëreni veten të lirë sot në qiellin e pastër dhe një efekt i yllit magjik do të bjerë mbi ju! Venusi dhe Marsi, edhe pse në kundërshtim me njëri-tjetrin e mbrojnë dashurinë tuaj. Beqarët do të duhet të punojnë shumë për të mos lejuar ndërhyrje në jetën e tyre private. Neptuni konfirmon rezultatet e habitshme në punë, kështu që lini frikën tuaj dhe kthehuni në lojë.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Dita e rëndësishme për dashurinë, mund të strehoheni dhe ta ripërtërieni pasionin me të dashurin/en tuaj. Kush dëshiron të përtërihet do të gjejë bukë për dhëmbët e tij! Saturni inkurajon edhe beqarët të përpiqen të përmirësojnë sferën sentimentale, mund të kenë sukses. Mos humbni sot një guxim të caktuar në propozimin e zgjidhjeve novatore dhe të shkëlqyeshme.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Momenti është ideal për të bërë një kthesë në jetën tuaj, brenda familjes dhe në dashuri. Një marrëdhënie mund të zyrtarizohet, mund të merrni hapin për të jetuar bashkë! Ka ndryshime edhe për shumë beqarë, ata që kërkojnë shpirtin binjak kanë shumë mundësi ta gjejnë atë. Hëna në fushën profesionale ju tregon projekte në një perspektivë pak optimiste.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Projekte martesë për shumë Bricjap në çift po vijnë. Plane të mira që do sjellin vetëm lumturi për të dashëruarit. Flittime të reja edhe për beqarët, disa prej të cilëve mund të përtojnë zhgënjime, por mos u trembni nga përvojat e reja. Mos i neglizhoni angazhimet tuaja në punë, në mesin e sektorëve që do të japin kënaqësi të madhe për shumë prej jush ka edhe fitime.




UJORI 21. janar - 19. shkurt

Një ditë e ndërlikuar, por ju ende do të përfitonit nga ajo. Shmangni me kujdes situatat që përfshijnë rrezikun e keqkuptimit me të dashurin/en tuaj. Nëse jeni vetëm ju do të jeni në gjendje shpirtërore për të bërë blerje dhe do të kënaqeni me këto teka. Jeni të vetëdijshëm për aftësitë tuaja në punë dhe në sajë të kësaj jeni duke përjetuar një moment fortësie dhe rinovimi.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

A jeni gati për një ditë fantastike? Venusi luan rolin e tij dhe sot sinjalizon një moment të harmonisë së shkëlqyer me partnerin/en. Nëse jeni vetëm do të duhet të dilni nga kthetrat dhe të rritni mbrojtjen tuaj, disa thashetheme mund të prishin reputacionin tuaj. Harmonia midis Hënës dhe Jupiterit favorizon të ardhurat e parave, një fitim që nuk e prisnit në këto kohë.



NE KETE DATE

JEKË E PAFUNDME, PERJETESI	FUTBOLLISTI DH TRAJNERI SHQIPTAR NË FOTO	AKT. AMERIKAN, NESON	KLUBI TËTOVAR, QË E UDHEHOQ TRAJNERI NË FOTO	L	HUMBJA E NDJENJAVE TË ORGANJEVE
A					
E ZË					
HUMBJA NË MJETE, DËMTIMI					
INDIUMI				RUMANIA	TRAJNERI I FAMILJES NË MANÇESTER JUNAJTEDIT
VEÇOJ					
JELEK, TRIKO PAMËNGË					
HAJDE BRISKU					NJËSIA PREJ 2.5 CM
Mensur Mamuti	LËNGU I HIDHUR I MELÇISË	FJALË (BISED.)	FUTBOLLISTI TOGOAN, SHEJLI EMANUEL	YLLI BRAZILIAN, ARTUR ANTUNES KOIMBRA	LUKUNI, ZOGORI
KLUBI SHKODRAN, QË E UDHEHOQ TRAJNERI NË FOTO					AKTORJA AMERIKANE, VUD
QË LIDHET ME RADUISIN					FREDERIK NDOCI
NDIKIMET					VOLTI
REOMIRI	FUTBOLLISTI GJERMAN, ZHEROM				NDARAS
KRYEQYTETI I LETONISË	BURIMI				VIDEO-LOJË E FAMSHME
R				ELEMENT KIMIK	
POLITIKANI KOSOVAR, VETON	MARRËVESHJE (BISED.)			POLITIKANI ZVICERAN, MARTI	
	UNIVERSITETI I PRISHTINËS				TRAJTË E EMRIT
S					BLEDI NASKA
LLOJ SËMUNDJEJE NERVORE				GUR GËLQEROR, ÇMERS	
				INTENSITETI	

ZGJIDHJET: L, AMSHIM, EKAP, DËMI, IN, R, NDAJ, ZHILE, EJA, ZHGANI, VLAZANIA, FN, RADIAL, VEC, EFEKTE, RI, R, BOATENG, RIGA, LITUM, UJDI, RASA, SURROI, BIGORR, PARKINSONI.

Sudoku

shumë i lehtë mesatar

8				9		3							4	2		5		
5		2	8	1		9				4				6			2	
	9		7		2								3			8	1	
				2				5	9	3								
4		9				7		2	4		8					5	6	
	2					3											7	9
9	4			3		1		7	1	7			2					
					6	7	4		3			6					1	
					2			6	8		2		9	5				

Shumë i lehtë: 871495326, 532816947, 694732581, 183279654, 469158732, 725643819, 946381275, 218567493, 357924168. Mesatar: 891742653, 543186792, 762539481, 937265148, 418397526, 256418379, 175823964, 389674215, 624951837.

PUNOI 18 MUAJ, NDËRSA MORI PAGË PËR 15 VITE

Një nëpunës në Spanjë, ka punuar vetëm 18 muaj në jetën e tij profesionale 15 vjeçare ndërkaq pjesën tjetër e ka kaluar me leje e raporte mjekësore dhe ka marrë pagë. Sipas lajmit të publikuar nga gazeta El País, nëpunësi i cili punonte si asistent në një spital psikiatrik në qytetin Alicante në juglindje të Spanjës, në vitet 2001-2016 sapo mbaronte ditët e lejes, merrte raport mjekësor dhe këtë e përsëriste vazhdimisht. Gjatë kësaj periudhe, nëpunësi ka marrë raport për 4.553 ditë edhe atë 7 herë raport mjekësor 1 vjeçar dhe 3 herë nga 1 vit e gjysmë. Jashtë raporteve, nëpunësi ka përdorur dhe leje ligjore dhe për këtë periudhë ka punuar vetëm 18 muaj. Alejandro Moral, një nga zyrtarët e qytetit, në deklaratën e tij ka theksuar se sado që veprimi nuk është etik, ai është legal dhe se ndaj nëpunësit i cili ka vepruar brenda kornizave ligjore kanë hapur hetim disiplinor. Ndërkaq nëpunësi



në fjalë, e fitoi padinë ndaj Këshillit Kombëtar për Sigurim Social meqenëse dëshmoi se nuk e kanë informuar se pas mbarimit të raportit do të duhet të kthehet në punë. Mësohet se nëpunësi, i cili në kuadër të ligjit për mbrojtje të të dhënave personale nuk është i detyruar të

tregojë sëmundjen e cila sipas tij e ka penguar në kryerjen e detyrës, ka vazhduar të marrë pagë prej 1.500 eurove. Gjithashtu theksohet se nëpunësi hetimet për të cilin vazhdojnë akoma, nuk kishte leje zyrtare por ka trajtuar pacientët për 30 minuta në javë.

Shri Lanka, shteti me më së shumti festa zyrtare

Në krye të listës së vendeve me festat më të shumta publike renditet Shri Lanka me 25 ditë jo-punë. Pason India me 21 festa shtetërore, Kolumbia dhe Filipinet me 18, Kinë dhe Hong Kongu me 17, Tajlanda, Turqia dhe Pakistan me 16, Japonia, Argjentina dhe Suedia me 15 festa. Çdo pushim kombëtar përcaktohet me ligj. Përjashtimi i vetëm bën Britania e Madhe, ku nuk ka ditë të paguara për festë, por ato kompensohen ndryshe. Britanikët kanë 28 ditë pushim në vit, transmetojnë mediat botërore.

Zbulohen aplikacionet që vjedhin fjalëkalime në Facebook

Ekspertët e sigurisë kompjuterike kanë zbuluar një problem të ri, të quajtur GhostTeam, në së paku 56 aplikacione në dyqanin e Google Play. GhostTeam dedikohet për vjedhjen e emrave të përdoruesve dhe fjalëkalimeve në Facebook. Ai fshihet në formën e aplikacionit për baterinë e llambës, kompasit, skanerit dhe kodeve QR, pastrimit të telefonit të mençur, argëtimeve në forma të ndryshme dhe shkarkimeve të videove. Siç ndodh shpesh, vetë aplikacionet nuk përbajnë kod me qëllim të keq, andaj lejohen të përfshihen në katalogun e Google Play. Ky 'malware' mbledh informacione rreth pajisjes, vendndodhjen, gjuhën dhe parametrat e shfaqjes. Sa më shpejt që ju të hapni aplikacionin në Facebook, ai do të kërkojë serish nga ju kyçje në formë verifikimi, por kur ju do të shkruani emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin, ato të dhëna do t'i dërgohen autorit të virusit. GhostTeam është zbuluar nga Avast dhe Trend Micro. Besohet se kjo është një çë-



shtje e punës së një zhvilluesi vietnamez, pasi gjuha vietnameze është përdorur për të shkruar kodin e kompjuterit. Aktualisht, përdoruesit e Android në Indi, Indonezi, Brazil, Vietnam dhe Filipine janë në rrezik më të lartë, shkruan Hacker News.

Seks me nxënësin 14-vjeçar, mësuesja përfundon në pranga

rohej një qytetare modele pavarësisht nga çdo dyshim. 29-vjeçarja Dori Myers, gruaja e një zv.sherifi dhe docente në "New School for Leadership and the Arts", të Kingsbrixh, në Nju Jork, është arrestuar të premtën në mbrëmje pas dëshmisë së një nxënësi që kishte parë mësuesen të shkëmbente mesazhe telefonike me një tjetër nxënësi, gjë që ka sjellë hapjen e një hetimi, në fund të të cilit e reja përfundoi në pranga. Në gjykatë, Dori ka treguar gjithçka: "Në këtë qytet mjafton akuza e dikujt për të arrestuar një person. Dori është një qytetare model, e cila mezi pret që emri i saj të vihet në vend", ka thënë avokati i saj, Andrew Stoll. Në pritje të gjyqimit, gjykatësjja Laura Drager ka lëshuar një urdhër-

mbrojtjeje prej 30 ditësh që nuk lejon asnjë kontakt me 14-vjeçarin, ndërsa departamenti i Edukimit, që i cilëson akuzat "thellësisht shqetësuese", i ka hequr gradën, duke i lënë detyra që e mbajnë larg nxënësve. Dori, e cila në të shkuarën kishte postuar në rrjetet sociale një foto ku mbante veshur një bluzë me mbishkrimin "Champagne All Day", ndërsa mbante në duar një shishe shampanjë, ka hequr së fundmi një postim tjetër, ku shfaqej me një bluzë të bardhë ku shkruhej: "Whiskey Makes Me Frisky" (Uiski më bën të gjallë). Dhe në një "tweet" të vitit 2015, i hequr edhe ky, deklaronte se nxënësit komentnin shpesh "look"-un e saj. Problemi për të, lindi kur nuk u kënaq më nga komentet e thjeshta.



Përpjekja e frutit të ndaluar nuk ka kursyer as atë, e cila deri dje konside-

1504 - Me Traktatin e Lionit, Franca i dorëzon Napolin Ferdinandit të Aragonit.
1627 - Bankroton qeveria spanjolle.
1876 - Shtetet e Bashkuara urdhërojnë që të gjithë amerikanët vendas të zhvendosen nëpër rezervate.
1915 - Sulmi i parë i gjermanëve me gaz helmues kundër rusëve.
1929 - Leon Trotsky dëbohet nga Rusia në Turqi.
1977 - Francezi Francois Claustre lirohet pas 33 muajve i mbajtur peng në Çad
1980 - Turmë policësh okupojnë Ambasadën spanjolle në Guatemala Siti duke vrarë 41 person
1986 - Mary Lund of Minn, është femra e parë që ka pranuar zemrën artificiale.
1990 - Hapet lokali i parë i McDonalds në Rusi.
1995 - Kryetari Bill Clinton autorizon 20 miliard dollarë amerikan hua për Meksikën për të stabilizuar ekonominë e saj.

Ndër astronomët më të njohur arab ishte Gjilbër Al Tarik. Udhëtimi i tij në mbarë botën la gjurmë të mëdha në fuqishën e astronomisë. Në nder të tij, ngushtica që ndanë Evropën dhe Afrikën e veriut mori emrin e tij NGUSHTICA E GJILBARTARIT.



Profili i mbretëreshës se Anglisë, Elisabeta është me i shfaquri në botë, në plot 33 shtete. I pari është realizuar kur ajo ishte vetëm 9 vjeçare.



"Taipan" është njëri prej gjarpërinjve më helmues në botë. Bëhet fjalë për një gjarpër të madh dhe të shpejtë australian, që ushqehet kryesisht me brejtës si minj. Helmi i tij është 7 herë më i fuqishëm sesa ai i një gjarpri me zile dhe 50 herë më shumë sesa ai i një kobre të zakonshme.



GRUAJA E NASIT

Një burrë po pyeste një grua në një ballkon pallati në kat të dytë:
- Më fal e di ku e ka shtëpinë Nasi??
- Kush Nas se ne kemi dy Nasa në këtë pallat - i përgjigjet gruaja.
- Si të ta them, por me duket se e ka pak gruan tip kurve, i thotë miku.
- Aaa dashke burrin tim ti - ja kthen ajo.



Politikanët janë gjithandëj të njëjtë. Ata premtojnë të ndërtojnë një urë edhe aty ku nuk ka lumë.
(Nikita Hrushov)



KALENDARI HISTORIK 31 JANAR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS